



SEMESTRI I PARË

# USULI FIKH

KOMENTIMI I LIBRIT “EL-  
VEREKAT” I IMAM EL-XHUVEJNIT



## Hyrje

Diçka mbi autorin Imam ElXHuvejni:

### **Emri:**

Ai është Abdulmelik Abdullah bin Jusuf bin Muhamed Elxhuvejni, i lindur në vitin 419h. Ndryshe njihet edhe si EbuElMeali, por edhe si Imam i dy haremeve.

### **Origjina:**

Me origjinë është nga Xhuvejn, vend në periferi të Nisaburit, pjesë e provincës së Khurasanit, në Iranin e sotëm.

### **Kërkimi i Diturisë:**

Duke marrë parasysh se rrjedh nga një familje me dituri fetare, mësimet e para i morri nga babai i tij i cili ishte nga dijetarët shafiiij. Pastaj vazhdoi udhëtimin e tij në kërkim të diturisë, udhëtim i cili zgjati rreth dhjetë vite, ku dhe takoi një numër të madh të dijetarëve.

### **Libri El-Verakat**

Një ndër librat e shumta të Imam ElXhuvejnit është edhe libri ElVarakat. Elvarakat është shumësi i fjalës ElVaraka që d.t.th. fletë.

Është vetë autori ai i cili e emërtoi librin, ku në fillim të librit citon: *“Këto janë disa fletë që përmbajnë pjesë nga Usuli Fikhu”*

Është një libër i cili në vete ndërthur shumicën e kaptinave të Usuli Fikhut, të renditura mirë, andaj edhe ka pasur një përkujdesje të veçantë të dijetarëve të mëvonshëm mbi të. Mbi këtë libër janë bërë mbi tridhjetë punime, duke përfshirë edhe shpjegime të tij.

### **Renditja e Skriptës**

Siç do e vini re, skripta është renditur në një formë të veçantë, formë kjo që është praktikë e dijetarëve të cilët merren me shpjegimin e librave.

Ne nuk jemi në rangun e tyre, por nga tradita e kërkuesve të diturisë ka qenë pasimi i mënyrës së kërkimit të diturisë si dhe dhënies së saj, në formën që e kanë ndjekur dijetarët më të ditur.

D.t.th. në pjesën e sipërme të faqes do të figuron teksti i autorit ElXhujeni, ndërsa në pjesën poshtë do figuron shpjegimi i asaj që gjendet lartë.

Kjo mënyrë është me e lehtë edhe për nxënësin, i cili para vetes do ketë të shënuar tekstin bazë, e ndër të shpjegimin e të njëjtit. Kjo do i ndihmon si në aspektin e kuptimit të drejtë dhe të menjëhershëm të tekstit bazë, por edhe në të mbajturit mend ku do bën të ashtuqajturin memorizim fotografik.

*Këto janë disa fletë që përmbajnë pjesë nga Usuli Fikhu.*

*Termi Usul el-Fikh është i përbërë prej dy pjesëve që dallojnë njëra prej tjetrës:*

*Njëra është el-Usul (الأصول), dhe tjetra el-Fikh (الفقه).*

*El-Aslu (الأصل) është ajo mbi të cilën ndërtohet diçka tjetër.*

*El-Fer'u (الفرع) është ajo që ndërtohet mbi diçka.*

*Fikhu është njohja e dispozitave fetare që janë vendosur përmes Ixhtihadit.*

---

**Përkufizimi gjuhësor:** (الأصل) el-Aslu është ajo mbi të cilën ndërtohet diçka tjetër.

**Përkufizimi terminologjik:** el-Aslu tek fukahatë dhe dijetarët e usulit i ka tre kuptime:

1. Është argument.
2. Rregull e vazhdueshme
3. Esenca në të cilën behet kijas (analogji)

*El-Fer'u (الفرع) është ajo që ndërtohet mbi diçka.*

**Në terminologji:**

**Usuli fikhu:** është lëndë e cila merret me studimin e argumenteve të fikhut në përgjithësi, mënyrën e përfitimit prej tyre si dhe gjendjen e përfituesit.

Fikhu: Fikhu është njohja e dispozitave fetare që janë vendosur përmes Ixhtihadit.

**Vendimi shariatik mbi Usuli Fikhun:**

Mësimi i Usuli Fikhut është Farz kifaje.

**Referencat e Usuli Fikhut:**

- a) Teuhidi
- b) Gjuha Arabe
- c) Rregullat shariatike

**Tematika:**

Gjërat për të cilat ka nevojë Muxhtehidi, dhe nga të cilat përfiton për nxjerrjen e rregullave shariatike.

## [Llojet e dispozitave]

*Dispozitat janë shtatë:*

- 1- (الْوَأَجِبُ) Vaxhibi - E detyrueshme.
  - 2- (الْمَنْدُوبُ) Mendubi - E rekomanduar (e pëlqyeshme).
  - 3- (الْمُبَاحُ) Mubahi - E lejuar.
  - 4- (الْمَحْظُورُ) Mahdhuri - E ndaluar.
  - 5- (الْمَكْرُوهُ) Mekruhi - E papëlqyer.
  - 6- (الصَّحِيحُ) Sahihu - E vlefshme.
  - 7- (الْبَاطِلُ) Batili - E pavlefshme.
- 

ElAhkam është shumësi i fjalës hukm, që në gjuhë d.m.th. ndalesë, gjykim.

Hakeme Allahu fi hadhihi elmesele – Allahu gjyko i mbi këtë çështje dhe ndalo i kundërshtimin e këtij vendimi.

Hukmi është adresim i Ligjvënësit (Allahut) që ka të bëj me veprimet e mukelefinëve (personave që janë ngarkuar me obligime shariatike) pa marrë parasysh a është kërkesë, zgjedhje apo rrethanë.

Dispozitat ndahen në:

1. Dispozita ngarkuese.
2. Dispozita që lidhen me rrethanat.

**Dispozitë Ngarkuese:** Është adresim i Ligjvënësit për urdhëresë, ndalesë apo zgjedhje.

## الواجب – Vaxhibi

*Vaxhibi (e detyrueshme) është ajo, për veprimin e së cilës ka shpërblim dhe për lënien e së cilës ka dënim.*

---

**Përkufizimi gjuhësor:** i rënë

**Përkufizimi terminologjik:**

Vaxhibi është ajo që vepruesi saj shpërblehet, ndërsa lënësi meriton ndëshkimin ose ajo që Ligjvënësi e ka urdhëruar në mënyrë kategorike.

**Kategoritë e Vaxhibit:**

Vaxhibi në përgjithësi ndahet në tre kategori kryesore, e ato janë:

1. Ndarja e Vaxhibit sipas veprës:

- a) Vaxhibi i caktuar.
- b) Vaxhibi i pacaktuar.

2. Ndarja e Vaxhibit sipas kohës:

- a) Vaxhibi me kohë veprimi të gjerë.
- b) Vaxhibi me kohë veprimi të ngushtë.

3. Vaxhibi sipas vepruesit:

- a) Vaxhib *ajni*.
- b) Vaxhib *kifaje*.

### المنذوب – Mendubi

*Mendubi është ajo për veprimin e së cilës ka shpërblim dhe për lënien e së cilës nuk ka dënim.*

---

**Përkufizimi gjuhësor:** Thirrje për diçka, nxitje dhe kërkesë e vazhdueshme për të.

**Përkufizimi terminologjik:** Ajo që vepruesi saj shpërblehet, ndërsa lënësi nuk ndëshkohet, ose ajo që Ligjvënësi e ka urdhëruar në mënyrë jokategorike.

#### **Kategoritë e Mendubit:**

1. Veprimet për të cilat nxiste Pejgamberi ﷺ dhe nuk i linte ato.

- a) Vepra që nuk i linte as ne vend, e as në udhëtim (suneti i sabahut)
- b) Vepra që nuk i linte ne vendin e vet (sunetet e drekës)

2. Ajo që i Dërguari i Allahut nxiti me fjalë edhe pse ndoshta nuk e vepronte vetë.

3. Veprat e të dërguarit ﷺ, të cilat ndonjëherë i linte.

## المباح – Mubahu

*Mubahu është ajo, për veprimin e së cilës nuk ka shpërblim dhe për lënien e së cilës nuk ka dënim.*

---

**Përkufizimi gjuhësor:** Lejim, zgjerim apo shtrirje.

**Përkufizimi terminologjik:** Mubahu është ajo, për veprimin e së cilës nuk ka shpërblim dhe për lënien e së cilës nuk ka dënim, ose ajo vepër, për të cilën njeriu është lënë i lirë, ta vepron apo ta lë atë.



## المحذور - Mahdhuri

*Mahdhuri është ajo, për lënien e së cilës ka shpërblim dhe për veprimin e së cilës ka dënim.*

---

**Përkufizimi gjuhësor:** d.m.th El-Memnu - i ndaluar. Ndryshe njihet edhe si Haram

**Përkufizimi terminologjik:** Mahdhuri është ajo, për lënien e së cilës ka shpërblim dhe për veprimin e së cilës meritohet dënim, ose kërkesa e prerë e Ligjvënësit për lënien e një veprë.

Vini re: Harami është e kundërta e hallallit – te dijetaret e fikhut, ndërsa te dijetaret e usulit e kundërta e haramit është vaxhibi, sepse këtu flitet për kuptimin e tyre jo për vendimin e tyre.

### **Kategoritë e Haramit:**

#### **1.** Ndarje sipas madhësisë së Haramit

- a) Mëkate të mëdha
- b) Mëkate të vogla

#### **2.** Ndarje sipas llojit të Haramit

- a) I ndaluar në veten e tij
- b) I ndaluar jo nga vetja e tij, por si shkak i ndonjë arsye tjetër

#### **3.** Ndarje sipas kohëzgjatjes së ndalesës

- a) E ndaluar përgjithmonë
- b) E ndaluar në raste të veçanta

### المكروه – Mekruhi

*Mekruhi është ajo, për lënien e së cilës ka shpërblim dhe për veprimin e së cilës nuk ka dënim.*

---

**Përkufizimi gjuhësor:** El-Mekruh, e kundërta e El-Mehbub, qe do të thotë e papëlqyer, jo e dashur, e urryer.

**Përkufizimi terminologjik:** Mekruhi është ajo, për lënien e së cilës ka shpërblim dhe për veprimin e së cilës nuk ka dënim, ose ajo të cilën e ndaloi Ligjvënësi, në mënyre jo të prerë.

**Dispozitat që lidhen me rrethana**

*Sahihu është ajo që pranohet (merret parasysh) dhe zbatohet.*

*Batili është ajo që nuk pranohet (merret parasysh) dhe nuk zbatohet.*

---

### [Disa terme të Usuli Fikhut]

*Fikhu është më specifik sesa dija (العِلْمُ).*

*Dija është njohja e diçkaje në realitetin e saj.*

*Injoranca është njohja e diçkaje në të kundërtën e realitetit të saj.*

*Dija e domosdoshme (العِلْمُ الضَّرُورِي) është dija që nuk vjen si rezultat i studimit (نَظْر) ose argumentimit (اسْتِدْلَال). Siç është dituria e përfituar nëpërmes njërës prej pesë shqisave: shqisa e dëgjimit, shikimit, nuhatjes, shijes dhe prekjes, apo nëpërmes tevatur-it.*

*Ndërsa dija e përfituar (العِلْمُ الْمُكْتَسَب) është ajo që ka nevojë për studim (نَظْر) dhe argumentim (اسْتِدْلَال).*

*Reflektim (نَظْر) është të menduarit rreth diçka.*

*Argumentimi (اسْتِدْلَال) është kërkimi i provës (dëshmisë).*

*Prova (الدَّلِيل) është ajo që udhëzon drejt asaj që synohet.*

#### Llojet e diturisë:

**a) Dija e domosdoshme (العِلْمُ الضَّرُورِي) është dija që nuk vjen si rezultat i studimit (نَظْر) ose argumentimit (اسْتِدْلَال). Siç është dituria e përfituar nëpërmes njërës prej pesë shqisave: shqisa e dëgjimit, shikimit, nuhatjes, shijes dhe prekjes, apo nëpërmes tevatur-it.**

Edhe dija e domosdoshme në esencë është e përfituar. Argument kemi fjalën e Allahut: “Është Ai i cili të krijoj dhe ti nuk dije asgjë..”

**b) Dija e përfituar- (العِلْمُ الْمُكْتَسَب) është ajo që ka nevojë për studim (نَظْر) dhe argumentim (اسْتِدْلَال).**

**Reflektim (نَظْر) është të menduarit e thellë rreth diçka.**

**Argumentimi (اسْتِدْلَال) është kërkimi i provës.**

**Prova (الدَّلِيل) është ajo që udhëzon drejt asaj që synohet.**

*Dija e mundshme (الظَّنُّ) është t'i konsiderosh dy çështje të mundshme, me përparësi të njëjës mbi tjetrën.*

*Dyshimi (الشَّكُّ) është t'i konsiderosh dy çështje të mundshme, pa përparësi të njëjës mbi tjetrën.*

---

Flasim këtu për të kundërtën e diturisë së domosdoshme dhe të njëjtën autori e ka ndarë në dy pjesë:

*a) Dyshimi (الشَّكُّ) është t'i konsiderosh dy çështje të mundshme, pa përparësi të njëjës mbi tjetrën.*

*b) Dija e mundshme (الظَّنُّ) është t'i konsiderosh dy çështje të mundshme, me përparësi të njëjës mbi tjetrën.*

Dijetarët dijen e mundshme e kanë ndarë në:

- **Edh-dhan**, të cilin po e përmendim në përgjithësi, dhe
- **Galebet edh-dhan**, - dija e mundshme me probabilitet me të madh sesa edh-dhan.

Sa i përket dispozitave fetare, të njëjtat ndërtohen mbi tre gjëra:

Jekin, Galebet el dhan, Edh-dhan

*Usul el fikhu merret me argumentet e përgjithshme të fikhut dhe metodologjinë e përdorimit të tyre.*

---

Është edhe një detaj i rëndësishëm që dijetarët ia kanë bashkangjitur këtij definicioni edhe pse autori i librit nuk e ka përmendur, e ai është: “*dhe gjendja e atij i cili i përdor dhe përfiton prej këtyre argumenteve*”.

Këtu është për qëllim gjendja e muxhtehidit, pra atij i cili i përdor këto argumente në usul el fikh.

**[Kapitujt e Usuli Fikhut]**

Prej kapitujve të Usuli Fikhut janë:

- 1- (الكَلَامُ) Ligjëratë
  - 2- (الأَمْرُ) Urdhri
  - 3- (النَّهْيُ) Ndalesa
  - 4- (العَامُّ) Shprehja e përgjithshme
  - 5- (الْخَاصُّ) Shprehja specifike
  - 6- (المُجْمَلُ) Shprehja e pa definuar
  - 7- (المُنَبِّئُ) Shprehja e definuar (e sqaruar)
  - 8- (الظَّاهِرُ) Shprehja e qartë
  - 9- (المُؤَوَّلُ) Shprehja e interpretuar
  - 10- (الأَفْعَالُ) Veprimet
  - 11- (النَّاسِخُ) Teksti shfuqizues
  - 12- (الْمَنْسُوخُ) Teksti i shfuqizuar
  - 13- (الإِجْمَاعُ) Konsensusi/Konsensusi
  - 14- (الأَخْبَارُ) Transmetimet
  - 15- (الْقِيَاسُ) Analogjia
  - 16- (الْحَظْرُ وَالْإِبَاحَةُ) Ndalesa dhe lejueshmëria
  - 17- (تَرْتِيبُ الْأَبْلَةِ) Renditja e provave (argumenteve)
  - 18- (صِفَةُ الْمُفْتِيِّ وَالْمُسْتَفْتَى) Cilësitë e myftiut dhe mystefiut
  - 19- (أَحْكَامُ الْمُجْتَهِدِينَ) Vendimet lidhur me muxhtehidët.
-

### [Llojet e ligjëratës]

*Ligjërata ndërtohet prej së paku:*

1. *Dy emrave*
2. *Një emër dhe një folje*
3. *Një folje dhe një parafjalë*
4. *Një emri dhe një parafjalë.*

*Ligjërata klasifikohet në:*

- 1- *Urdhëresa*
- 2- *Ndalesa*
- 3- *Fjali dëftore*
- 4- *Fjali pyetëse.*

*Llojet tjera përfshijnë:*

- 1- *Fjali dëshirore*
- 2- *Fjali sugjeruese*
- 3- *Betime*

**Përkufizimi gjuhësor:** Ligjërata është shprehje e vendosur për një kuptim (ar.).<sup>1</sup>

**Përkufizimi terminologjik:** Është diçka e cila sjell kuptim, d.m.th diçka dobiprurëse.

<sup>1</sup> Formë e ndërtimit sintaksor të ligjëritimit, në të cilën ai që flet a shkruan i riprodhon fjalët e një tjetri ose fjalët që ka thënë vetë më parë pa bërë ndryshime në përmbajtje, por me ndryshime në formë, duke mos i veçuar si fjali më vete.



*Në aspekt tjetër ndahet në:*

1. (حَقِيقَةٌ) *E fjalëpërfjalshme*

2. (مَجَازٌ) *Figurative.*

*E fjalëpërfjalshme (حَقِيقَةٌ) është kur përdoret sipas shprehjes së thënë; dhe thuhet: Është e fjalëpërfjalshme kur përdoret sipas terminologjisë së njerëzve që flasin. Figurative (مَجَازٌ) është kur del përtej kontekstit të shprehur.*

*Përdorimi i fjalëpërfjalshëm ose është: Gjuhësor, fetar apo i zakonit.*

### ***I. Përdorimi i fjalëpërfjalshëm i ligjëratës***

Ligjëratat e fjalëpërfjalshme (حَقِيقَةٌ) është kur përdoret sipas terminologjisë së njerëzve që flasin.

D.m.th kemi një grup specifik njerëzish të cilët flasin me një gjuhë specifike për ta.

Autori kuptimin e fjalëpërfjalshëm, e ka ndarë në tre lloje:

a) Kuptimi i fjalëpërfjalshëm gjuhësor.

Shembull: Fjala EsSalah d.m.th lutje apo fjala EsSijam d.m.th abstenim. Kjo është realiteti i tyre gjuhësor.

b) Kuptimi i fjalëpërfjalshëm fetar.

Nëse e marrim në kuptim të fjalëpërfjalshëm fetar, do ta shohim se të njëjtat fjalë kanë kuptim tjetër p.sh EsSalah nënkupton namazin që në terminologji është adhurim i cili fillon me tekbir dhe mbaron me selam.

c) Kuptimi i fjalëpërfjalshëm i zakonit.

Shembull: Kemi fjalën “EdDabbeh” që d.m.th gjallesë. Mirëpo për disa njerëz ka kuptimin e gjallesës me katër këmbë, edhe pse në realitet fjala “EdDabbeh” ka për qëllim çdo gjallesë.

### ***II. Përdorimi figurativ ose MEXHAZ.***

Figurative (مَجَازٌ) është kur del përtej kontekstit të shprehur.

Është e kundërta e Hakikah d.m.th nuk përdoret në terminologjinë e njohur tek njerëzit.

Shembull: Fjalja “E pushë një luan” ky është kuptim real i kësaj fjalie, e cila na e bën me dije se personi e ka parë kafshën e njohur, luanin.

“ E pashë një luan me shpatë në dorë” kjo fjali përmban kuptim figurativ, sepse këtu luani përdoret për të përshkruar trimërinë e një njeriu.

*Përdorimi figurativ ose është:*

1. *Figurativ përmes shtojcës*
2. *Figurativ përmes mangësimit*
3. *Figurativ përmes zëvendësimit*
4. *Figurativ përmes metaforës.*

1. *Figurativ përmes shtojcës, siç është në fjalën e Tij (أَلَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ) - Lejse ke mithlihi shej'un!<sup>1</sup>*

b) *Figurativ përmes mangësimit, siç është në fjalën e Tij (وَاسْأَلِ الْقُرْيَةَ) Ues'eli-l-karjete.<sup>2</sup>*

c) *Figurativ përmes zëvendësimit siç është (الْعَائِطُ) el-Ghaitu, sa i përket jashtëqitjes njerëzore.*

d) *Përmes metaforës*

*Figurative përmes metaforës është si në fjalën e Tij (جِدَارًا يُرِيدُ أَنْ يَنْقَضَ) Xhidaren juridu en jenkadda.<sup>3</sup>*

---

<sup>1</sup> Përkthimi: Asgjë nuk i shembëllen Atij. (Esh-Shura 11)

<sup>2</sup> Përkthimi i fjalpërfjashëm: Pyete vendbanimin (fshatin. (Jusuf 82)

<sup>3</sup> Përkthimi i fjalpërfjashëm: Një mur që dëshiron të bjen. (El-Kehf 77)

## URDHRI (ElEmru) dhe NDALESA (EnNehju)

[Urdhri (الأمر)]

*Urdhri është kërkesë verbale për veprim, ndaj dikujt që është më ulët se ai, në formë detyruese.*

---

**Përkufizimi gjuhësor:** Është kërkesë apo kërkesë për veprim të diçkaje të vlefshme.

**Përkufizimi terminologjik:** Është kërkesë verbale për veprim, e cila i drejtohet dikujt që është në pozitë më të ulët se ai që e bën kërkesën, në formë detyruese.

Kur jemi te kërkesat duhet të cekim se kërkesat janë tri llojesh:

- ❖ Kërkesa ndaj dikujt që është më lartë se ne, quhet lutje.
- ❖ Kërkesa ndaj dikujt që është i njëjtë me ne, quhet sugjerim.
- ❖ Kërkesa ndaj dikujt që është më ulët se ne, quhet urdhër.

*Forma' e saj është if'al (أَفْعَلٌ). Kur përdoret në mënyrë absolute dhe pa indikacion shmangës, kuptohet si detyrim, përpos nëse dëshmitë tregojnë që qëllimi (i urdhrit) është rekomandim ose lejueshmëri.*

*Sipas mendimit më të saktë nuk nënkupton përsëritje, përpos nëse ka dëshmi që tregon se ka për qëllim përsëritjen.*

*As nuk përmban menjëhershëmëri.*

Forma urdhërore në Kuran mund të vijë në 4 forma:

1. Forma (if'al) që në arabisht donë të thotë “bëje, kryeje”. **“Faleni namazin...”**.<sup>2</sup>
2. Përdorimi i qartë i termit urdhër. **“Allahu urdhëron për drejtësi, bamirësi...”**.<sup>3</sup>
3. Nëse në Kuran apo Synet përdoret termi obligoi, detyroi, shkroi, siç është fjala e Allahut: **“O ju njerëz, iu është obliguar agjërimi...”**<sup>4</sup>etj.
4. Kur diçka në fenë e Allahut cilësohet se është bindje ndaj Allahut dhe lëvdohet personi i cili e vepron këtë vepër, siç është thënia e Pejgamberit ﷺ: **“Unë dhe kujdestari i jetimit jemi kështu në Xhennet dhe tregoi me gishtin tregues dhe atë të mesëm.”**

### **Përsëritja**

Thotë autori: *Sipas mendimit më të saktë urdhri nuk përmban përsëritje, përpos nëse ka dëshmi që tregon se ka për qëllim përsëritjen.*

Dijetarët për këtë mesele kanë thënë: Sa i përket përsëritjes, urdhri ka mundësi që të vijë në tri forma:

1. Që të ketë indikacion të qartë se kjo vepër nuk duhet të përsëritet.

Si p.sh. ajeti Kuranor: **“Dhe njerëzit kanë obligim për Allahun të bëjnë Haxh në Shtëpi (Qabe), për atë që ka mundësi”**.<sup>5</sup>

Këtu, nga këndvështrimi i Usulit kuptohet se sa herë të paraqitet mundësia për kryerjen e haxhit, ndërsa kur është pyetur Pejgamberi ﷺ ka thënë: **“Jo, një herë në jetë.”**<sup>6</sup>

2. Urdhri të ketë indikacion të qartë se vepra duhet përsëritur.

Si p.sh. ajeti Kuranor: **“..dhe kur të jeni xhunub, pastrohuni”**.<sup>7</sup>

<sup>1</sup> Forma e saj morfologjike

<sup>2</sup> El-Bekare: 43

<sup>3</sup> En-Nahl: 90

<sup>4</sup> El-Bekare: 183

<sup>5</sup> Al-Imran: 97

<sup>6</sup> Muslimi: 1337

<sup>7</sup> El-Maide: 6

### 3. Kur nuk ekziston as e para e as e dyta

Autori ka thënë se sipas mendimit më të vërtetë nëse nuk ka argument të qartë që aludon se urdhri duhet të përsëritet, atëherë urdhri nuk përsëritet.

## Menjëhershmeria

Autori thotë: *As nuk përmban menjëhershmeri.*

Mendimi më i vërtetë është se urdhri përmban menjëhershmeri që d.m.th. se kur vjen urdhri dhe ekzistojnë mundësitë, duhet që njeriu patjetër ta bëjë veprën menjëherë, sepse Allahu ka thënë: “ **Shpejtoni drejt faljes së Allahut**”<sup>1</sup> kurse shpejtimi drejt faljes nuk vjen me vonimin e urdhrit të Atij i cili fal.

Argument nga Sunneti kemi hadithin e Hudejbies, ku i Dërguari i Allahut ﷺ u tha shokëve të tij: *"Ngrihuni dhe thorni kurbanet tuaj dhe rruani kokat tuaja. Për Allah, asnjë prej tyre nuk u ngrit edhe pse ai u tha tri herë! Kur asnjëri prej tyre nuk u ngrit, ai i la ata, shkoi tek Umm Selema dhe i tregoi asaj për sjelljen e njerëzve ndaj tij. Ajo i tha: "O Pejgamberi i Allahut! A do që të zbatohet urdhri yt? Dil dhe mos i thuaj askujt asnjë fjalë derisa të kesh therur kurbanin tënd! Pastaj thirri berberit të të rruajë kokën!" Kështu, Pejgamberi ﷺ doli dhe nuk i foli kurrkujt prej tyre asnjë fjalë, derisa kreu ato dy punë: theri kurbanin e tij, pastaj thirri berberin e vet, i cili i rruajti kokën. Sapo panë një gjë të tillë, shokët e Pejgamberit ﷺ u ngritën, therën kurbanet e tyre dhe filluan t'i rruajnë kokat njëri-tjetrit. Aq shumë nxituan, sa po u copëtonin me njëri-tjetrin".*<sup>2</sup>

<sup>1</sup> Al-Imran: 133

<sup>2</sup> Buhariu: 2581

*Urdhri për të kryer një veprim është urdhër për të kryer veprimin dhe për çdo gjë tjetër pa të cilën veprimi nuk plotësohet. Siç është urdhri për namaz, i cili është edhe urdhër për abdes, që e shpien atë deri në namaz.*

*Kur vepra kryhet, i urdhëruari konsiderohet të jetë i shkarkuar nga obligimi.*

---

Ndryshe tek dijetarët njihet se është vaxhib ajo gjë pa të cilën nuk plotësohet vaxhibi. Shembull: Abdesi për namaz, që d.m.th. se urdhri për namaz është edhe urdhër për abdes.

Autori thotë: *Kur kryhet vepra, i obliguari konsiderohet se është shkarkuar nga obligimi.*

Që d.m.th. e ka kryer obligimin e tij dhe ka dalë nga kjo përgjegjësi por me kushtet të cilat i kanë përmendur dijetarët. Nëse dikush e bën diçka vetëm si formalitet, nuk del nga përgjegjësia, siç ka thënë Pejgamberi ﷺ: *“Ai që nuk e lë gënjeshtren dhe të vepruarit me të si dhe shprehjen e injorancës, Allahu nuk ka nevojë që ai të përmbahet nga ngrënia dhe pirja.”*<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Buhariu:6057

## [Kush përfshihet në urdhëresat dhe ndalesat dhe kush nuk përfshihet]

*Besimtarët janë të përfshirë në atë që Allahu e adreson, ndërsa ai që harron, fëmija dhe i çmenduri nuk janë të përfshirë.*

*Jobesimtarët janë të përfshirë në adresimin për degët e Sheriatit dhe për atë pa të cilën këto degë janë jovalide, e ai është Islami, sepse Ai thotë (قَالُوا لَمْ نَكُ مِنَ الْمُصَلِّينَ) "Ata thanë: Ne ishim nga ata që nuk falën namaz".<sup>2</sup>*

*Urdhri për diçka është ndalesë për të kundërtën e saj, dhe ndalesa prej diçkaje është urdhër për të kundërtën e saj.*

---

Kur themi “besimtarët” e kemi për qëllim mukelefin, që përfshin edhe besimtarët.

Thotë autori: *Personi i cili harron, fëmija dhe i çmenduri nuk janë të përfshirë në këtë adresim.*

Këto tri gjendje janë si barrierë në mes adresimit të Allahut dhe kuptimit të të njëjtit adresim nga njeriu.

Mosbesimtarët janë të përfshirë në adresimin e Ligjvënësit për degët e sheriatit, dhe kjo nënkupton se padyshim janë të përfshirë edhe në adresimin për themelet e tij.

Shembull: Allahu thotë në Kuran: **“O ju njerëz adhurojeni Allahun”**.<sup>3</sup>

Këtu hyjnë të gjithë njerëzit pa marrë parasysh se a janë besimtarë apo mosbesimtarë.

Thotë Allahu: **“Përkitazi me kriminelët (e u thonë): “Çka u solli juve në Sekar?”** **“Ata thonë: “Nuk kemi qenë prej atyre që faleshin (që bënë namaz).” Nuk kemi qenë që ushqenim të varfrit”**.<sup>4</sup>

**Nëse ai si mosbesimtar e pranon Islamit a duhet t’i kryejë të gjitha veprat me të cilat ka qenë i obliguar më parë?**

Jo nuk duhet, dhe këtë e dëshmon fjala e Allahut të Madhëruar kur thotë:

**“Thuaju atyre të cilët kanë bërë kufër se nëse ndalen prej kufrit të tyre, Allahu jua fal mëkatet e mëparshme”**.<sup>5</sup>

Dhe në hadithin e Amr ibn Asit, ku i dërguari ﷺ i tha: **“A nuk e di se Islami rrënon (shlyen) çdo gjë që ka qenë më parë?”**.<sup>6</sup>

<sup>1</sup> El-Muddethir: 43

<sup>2</sup> El-Muddethir: 43

<sup>3</sup> El-Bekare:21

<sup>4</sup> El-Mudethir: 41-44

<sup>5</sup> El-Enfal: 38

<sup>6</sup> Muslimi



## **Cili është argumenti se nuk pranohen ibadetet e mosbesimtarëve?**

Thotë Allahu: *“E, lëmoshat e tyre nuk do të pranohen, ngase ata, nuk besojnë në Allahun dhe Pejgamberin e Tij.”*<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Teube: 54

## [Ndalesa (النَّهْيُ)]

*Ndalesa (النَّهْيُ): Kërkesë verbale për lënie, ndaj dikujt që është më ulët se ai, në formë detyruese. Dhe tregon pavlefshmërinë e asaj që është e ndaluar. Ndonjëherë forma e urdhërore përdoret me qëllim të lejimit, kërcënimit, barazisë, apo krijimit.*

---

**Përkufizimi gjuhësor:** kërkesë për lënie dhe ndalim nga diçka

**Përkufizimi terminologjik:** Ndalesa është kërkesë verbale për lënie ndaj dikujt që është më ulët se ai, në formë detyruese.

Pra, flasim për lënie të besimeve, fjalëve dhe lënie të veprimeve.

Nga ky përkufizim kuptojmë se ajo që është ndaluar është ndalesë e prerë - pra Haram. Dhe mbetet si e tillë përderisa nuk kemi ndonjë indikacion shmangës.

Thotë imam Shafiu: çdo gjë që e ka ndaluar Pejgamberi ﷺ është haram, derisa të vijë argument tjetër që aludon se ndalesa ka kuptim tjetër.

Shembull: namazi në varre ose drejt tyre, thotë i dërguari i Allahut ﷺ: “Mos u ulni mbi varre dhe mos u falni tek ato (në drejtim të tyre).”<sup>1</sup>

### I. Përsëritja

Më parë kemi thënë se urdhri nuk përmban përsëritje, ndërsa ndalesa përsëritet (vazhdon).

### II. Çka nënkupton ndalesa ?

Autori thotë: *Dhe tregon pavlefshmërinë e asaj që është e ndaluar.*

Ndalesa si ndalesë, nëse Allahu na e ka ndaluar një vepër, nënkupton se kryerja e kësaj veprë është e pavlefshme.

Pse themi se është e pavlefshme?

Argument për këtë është hadithi: “Kush vepron diç që nuk është në pajtim me çështjen tonë, ajo (vepër) është e refuzuar”<sup>2</sup>

Shembull: Namazi i atij që falet pa abdes.

---

<sup>1</sup> Muslimi 972

<sup>2</sup> Buhariu: 2697

## [Shprehja e përgjithshme (العَامُّ) dhe shprehja specifike (الْخَاصُّ)]

*Shprehja e përgjithshme (العَامُّ) është ajo që përfshin dy ose më shumë gjëra. Rrjedh prej thënies (عَمَّمْتُ زَيْدًا و عَمَّرًا بِالْعَطَايَا) – A'memtu zejden ue a'mren bi'l-a'taja dhe (عَمَّمْتُ جَمِيعَ النَّاسِ بِالْعَطَايَا) – A'memtu xhemi' en-nas bi'l-a'taja.*

*Ka katër lloje të shprehjeve:*

1. *Emër njëjës i shquar me nyjën shquese (الْ) -El*
2. *Emër shumës i shquar me nyjën shquese (الْ) -El*
3. *Emër i pacaktuar, si (مَنْ) -men për mendorë, (مَا) -ma për jo-mendorë dhe (أَيُّ) -ejju për të dyja. (أَيْنَ) -ejne për vend, (مَتَى) -meta për kohë, (مَا) -ma kur përdoret për pyetje, kushte dhe tjera, dhe*
4. *(لَا) -la me të pashquar*

*Shprehja e përgjithshme (الْعُمُومُ) përfitohet prej shprehjeve gojore dhe nuk mund të pretendohet me diçka tjetër, siç janë veprimet dhe të ngjashme me to.*

---

Autori ka përmendur 4 lloje të shprehjeve të përgjithshme.

**1. Emër njëjës i shquar me nyjën shquese Elif dhe Lam (-El-).**

P.sh. Kitabun – libër, ElKitabu – libri.

**2. Emër shumës i shquar me nyjën shquese (الْ) -El**

Shembull: Kutubun – libra, Elkutubu – librat.

**3. Emër i pacaktuar**

Autori ka përmendur ca shembuj edhe atë:

- MEN (kush) për frymorë (për njerëzit).

Shembull: **“Dhe kush punoi ndonjë të mirë që peshon sa grimca, do ta gjejë atë”**<sup>1</sup>

- MA (çka/çfarë) për jofrymorë (kafshë apo sende të ngurta pa shpirt).

Shembull: **“Dhe çfarë do lloj fatkeqësie që t’ju godasë nuk ndodh pa lejen e Allahut”**<sup>2</sup>

- EJJU (çdo kush, çdo send, çdo gjë), përdoret edhe për mendorë edhe për jo mendorë.

Shembull: **“Thuaj: Cila është dëshmia më e madhe”**<sup>3</sup>.

EJNE (ku) përdoret për vend.

Shembull: **“Dhe ku po shkoni”**<sup>4</sup>.

<sup>1</sup> El-zelzeleh:7

<sup>2</sup> Tegabun: 11

<sup>3</sup> El-Enam: 19

<sup>4</sup> Et-Tekvir:26

- META (kur) për kohëra.

- EJNE MA (kudo) për kohërat, shembull: ***“Vdekja do t’ju kapë kudo që të jeni”***<sup>1</sup>

4. (لَا)-la me të pashquar.

LA + diçka e pashquar. LA (jo, s’ka, nuk ka) është mohim (LA -nafije).

Shembull: ***“Kush bën (ia fillon të zbatojë) haxhin në këta muaj, nuk duhet afruar gruas, nuk bën mëkate të mëdha, as nuk duhet shkaktuar polemika”***.<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup> En-Nisa:77

<sup>2</sup> El-Bekare: 197

### الْخَاصُّ

(الْخَاصُّ) Shprehja specifike është e kundërta e shprehjes së përgjithshme.

Specifikimi është të veçosh diçka prej një tërësie.

Ndahet në:

1. I lidhur dhe
2. I ndarë.

I lidhur është ose: (الإِسْتِثْنَاءُ) përjashtim, ose i lidhur për një kusht, ose i lidhur për një përcaktor.

---

**Përkufizimi gjuhësor:** Është fjalë që tregon specifikim ose që tregon ndonjë lloj veçimi.

**Përkufizimi terminologjik:** Specifikim është të veçosh diçka prej një tërësie.

Disa dijetarë kanë thënë: është veçimi i një pjese të së përgjithshmes.

P.sh.: Erdhën mysafirët, përveç Halidit.

Pastaj autori ka vazhduar me ndarjet e ElKhas, dhe në fillim thotë:

1. *Specifikim i lidhur.* Është ai specifikim apo veçim i cili nuk mund të qëndrojë si i ndarë në fjali, d.m.th në atë rast fjalia nuk është e vlefshme.

P.sh: Erdhën mysafirët përveç Halidit. Pjesa e fjalisë ‘përveç Halidit’ nuk mund të qëndrojë si fjali në vete sepse nuk ka kuptim.

2. *Specifikimi i ndarë.* Është ai specifikim i cili mund të qëndrojë vetë (si i ndarë, si i vetëm). Këtu kemi të bëjmë me dy tekste të një dispozite.

Njëherë është përmendur njëri pastaj tjetri.

Shembull: “*Allahu ju urdhëron në fëmijët tuaj që mashkulli të marrë hise sa dy femra.*”<sup>1</sup>

Kjo është e përgjithshme. Kurse specifikimi ka ardhur në hadith: “*Myslimani nuk e trashëgon qafirin e as qafiri myslimanin.*”<sup>2</sup>

Të dy tekstet mund të qëndrojnë të ndarë pa ndihmën e njëri-tjetrit, por hadithi na tregon se këtu kemi një lloj specifikimi.

---

<sup>1</sup> En- Nisa:11

<sup>2</sup> Buhariu: 6764

## El Istithna (përjashtimi)

*Përjashtimi (الإِسْتِثْنَاءُ) është nxjerrja jashtë e asaj që përndryshe do të ishte përfshirë në shprehje. Është e vlefshme vetëm me kusht që të mbetet diçka nga tërësia prej së cilës është bërë përjashtimi. Dhe prej kushteve të saj është që të jetë lidhur me shprehjen (fjalimin).*

**Përkufizimi gjuhësor:** Nga fjala “thenij” që d.m.th përjashtim dhe shmangie

**Përkufizimi terminologjik:** Përjashtimi është nxjerrja jashtë e asaj që përndryshe do të ishte përfshirë në shprehje.

P.sh: Erdhën mysafirët përveç Halidit.

Pejgamberi ﷺ ka thënë: “Pajtimi apo marrëveshja është e lejuar mes myslimanëve, përveç(il-la) asaj që e bën Hallallin Haram dhe anasjelltas”.<sup>1</sup>

Pastaj autori i ka përmendur kushtet e specifikimit lidhur me përjashtimin.

- Kushti i parë: Të mbetet diçka nga tërësia prej së cilës është bërë përjashtimi d.m.th. tërësia bazike të mos humbet e gjitha, si p.sh: T’i dhashë 100 Euro përveç 100 Euro.
- Kushti i dytë: Të jetë e lidhur me shprehjen

Nëse dikush thotë: “Tërë pasurinë do ta jap sadaka”, pastaj hesht dhe pas një minute thotë: “përveç kaq dhe kaq”. Në këtë rast themi se ky përjashtim nuk vlen sepse ka lënë pauzë në mes. Kurse për fjalinë e parë themi se është e plotë.

<sup>1</sup>Tirmidhiu: 1352

*Lejohet që përjashtimi t'i paraprij asaj [prej të cilës bëhet] përjashtimi. Dhe lejohet që përjashtimi të bëhet prej llojit së të përjashtuarës ose prej një lloji tjetër.*

*Lejohet që kushti (الشَّرْطُ) të vonohet prej të kushtëzuarës dhe lejohet që t'i paraprij të kushtëzuarës.*

---

### **Si lejohet përjashtimi**

- *Lejohet që përjashtimi t'i paraprijë asaj prej së cilës bëhet përjashtimi.*

*-Dhe lejohet që përjashtimi të bëhet prej llojit të njëjtë me të përjashtuarën ose prej ndonjë lloji tjetër.*

Shembull:

*Ndërsa unë pasha Allahun, në dashtë Allahu nuk do të zotohem, dhe pastaj të shoh diç më të dobishme se ajo për të cilën u zotova, dhe do e veproj atë që është më e mirë.<sup>1</sup>*

- *Lejohet që përjashtimi të bëhet prej llojit të së përjashtuarës ose prej ndonjë lloji tjetër. E kemi për qëllim se tërësia është prej një lloji kurse përjashtimi prej një lloji tjetër.*

Thotë Allahu: **“Në Xhennet nuk dëgjojnë fjalë të kota përveç Selamit”<sup>2</sup>**

Këtu përmendet fjala e kotë dhe Selami dhe se që të dyja janë të llojeve të ndryshme. Selami nuk është pjesë e tërësisë së parë

Specifikimi i lidhur për një kusht.

Kushti këtu bëhet me إن (nëse) ose me diçka të ngjashme me të.

P.sh. Nëse më viziton do të gostisë.

---

<sup>1</sup>

<sup>2</sup> Merjem:62

*I lidhur për një përcaktor<sup>1</sup>, kuptohet si shprehje absolute (الْمُطْلَقُ), p.sh. lirimi i skllavit është veçuar me besim në disa raste, dhe është shprehje absolute në disa raste tjera, kështu që shprehja absolute kuptohet në përputhje me të veçuarën.*

---

### **Specifikimi i lidhur me përcaktor.**

Këtu nuk flasim për përcaktor gramatikor por për përcaktor siç kuptohet në Usul (sifeh).

Ajo (fjalë) e cila aludon në kuptimin që e përmban një pjesë e së përgjithshmes mund të jetë ose cilësor (cilësi, sifeh) ose zëvendësim (bedel) ose rrethanor i gjendjes.

Cilësor:

Shembull: ***“Juve ju ndalohen vajzat (Rabiibeh; e cila është vajza e gruas që vajzën e ka me burrë tjetër) e grave”<sup>2</sup>***

Zëvendësim apo bedel.

Shembull: ***“Për hir të All-llahut, vizita e shtëpisë (Qabes) është obligim për atë që ka mundësi”<sup>3</sup>***

Këtu fjalën en nas (njerëzit) mund ta vendosim te fjala menistetaa dhe pastaj mund t’i lexojmë kështu: ue lil-lahi ala menisteta’a hixhxhul bejti. Për Allahun ka obligim Haxhin ai që ka mundësi. Këtu specifikimi bëhet me zëvendësim.

Rrethanor i gjendjes.

Shembull: ***“Kush e vret besimtarin qëllimisht (muteammiden), dënimi i tij është Xhehenemi ku do të qëndrojë përgjithmonë”<sup>4</sup>***

---

<sup>1</sup> Përcaktor tek dijetarët e Usulit jo tek dijetarët e gjuhës

<sup>2</sup> Nisa:23

<sup>3</sup> Al-Imran:97

<sup>4</sup> En-Nisa: 93



## [ SPECIFIKIMI ]

*Lejohet specifikimi i një shprehje Kuranore me një shprehje tjetër Kuranore, një shprehje Kuranore me shprehje të Sunnetit, një shprehje të Sunnetit me një shprehje Kuranore, një shprehje të Sunnetit me një shprehje tjetër të Sunnetit, dhe specifikimi i shprehjeve me analogji. Me shprehje nënkuptojmë thënien e Allahut subhanehu ue tea'la dhe thënien e Pejgamberit sala Allahu alejhi ue sel-lem.*

---

### Llojet e specifikimeve:

#### 1. Përmes shqisave.

Pra nëpërmjet perceptimit mundemi të ndajmë diçka nga tërësia apo të bëjmë specifikim nga shprehjet e përgjithshme.

Ajeti: **“Shkatërrohet gjithçka me Urdhrin e zotit të saj”**<sup>1</sup>, këtu është përmendur termi *kulu* (gjithçka) e cila e bën shprehjen të përgjithshme.

Por në anën tjetër e shohim nëpërmjet shqisave se ajo erë nuk i ka shkatërruar malet, lumenjtë, planetin tokë, yjet, liqenet, diellin, hënën etj.

#### 2. Përmes logjikës (el aklu).

Ka mundësi që na vjen ndonjë shprehje e përgjithshme por logjika jonë e kupton se këtu duhet të bëhet një lloj specifikimi.

P.sh.: **“Allahu është krijues i çdo gjëje”**.<sup>2</sup>

Mirëpo nga ky ajet nuk mund të nxirret përfundim se Allahu është krijuesi i vetes së Tij.

#### 3. Përmes teksteve shariatike.

##### a. Specifikimi i një ajeti me një ajet tjetër.

Është kur specifikimi i një shprehjeje të përgjithshme Kuranore bëhet me Kuran.

Shembull: **“Gratë e lëshuara presin tre muaj, ose tre cikle mujore”**.<sup>3</sup>

Këtu flet për Iddetin (periudhë që pret gruaja pas shkurorëzimit dhe s’guxon të martohet me tjetër), por këtë ajet e specifikon ajeti tjetër : **“O besimtarë kur t’i martoni besimtare e pastaj t’i lëshoni përpara se të keni marrëdhënie intime to, atëherë nuk ka Iddet për ato”**<sup>4</sup>

<sup>1</sup> El-Ahkaf: 25

<sup>2</sup> Zumer:62

<sup>3</sup> El-Bekare:228

<sup>4</sup> Al-Ahzab:49

b. *Specifikimin e një shprehjeje Kuranore me Sunnet.*

Shembull: **“Dhe iu lejohet gjithçka jashtë këtyre”**.<sup>1</sup>

Por në Sunnet hasim fjalë të Pejgamberit ﷺ që bëjnë shpjegim apo specifikim: *“Le të mos martohet një grua me një burrë i cili është bashkëshort i hallës së saj ose i tezes së saj.”*<sup>2</sup>

c. *Specifikimi me konsensus (konsensus).*

Shembull: *“O ju besimtarë kur të thirreni për lutje ditën e Premte nxitoni për ta përmendur Allahun s.v.t. dhe pezullojeni shitblerjen”*<sup>3</sup>

Dhikrull-llah (përmendja e Allahut) këtu d.m.th. hytbeja e Xhumasë. Ky ajet i përfshin të gjithë mukel-lefinët që kanë iman, por ka Konsensus se në të nuk përfshihen gratë, fëmijët dhe skllëvërit.

d. *Specifikimi me Kijas (analogji).*

Nëse themi se specifikimi bëhet me analogji, atëherë ajo duhet të jetë e qartë dhe e dukshme. E nëse nuk është e tillë atëherë themi se është analogji e pavlefshme. Shembull: **“Laviren dhe lavirin kamxhikoni secilin prej tyre me nga njëqind goditje”**.<sup>4</sup>

Është specifikuar lloji i lavireve në Kuran, kur Allahu flet për robëreshat thotë: ***E kur të jenë të martuara ato, nëse bëjnë ndonjë punë të turpshme, ndëshkimi kundër tyre është sa gjysma e atij të grave të lira (jo robëresha).***<sup>5</sup>

Prej këtu bëjmë analogji për skllavin mashkull dhe themi se edhe ai i ka vetëm 50 goditje ndëshkuese për krimin e bërë.

e. *Specifikimi i Sunnetit me Kuran.*

Shembull: *“Jam i urdhëruar t'i luftoj njerëzit deri sa të thonë la ilahe il-la Allah...”*<sup>6</sup>

Por në suren Teube e kemi specifikimin: **“...derisa ta japin xhizjen...”**<sup>7</sup>

f. *Specifikimi i Sunnetit me Sunnet.*

Shembull: *“Ajo e cila ujitet me ujë nga qielli, jepet 10% e saj (si zeqat).”*<sup>8</sup>

<sup>1</sup> Nisa: 24

<sup>2</sup> Buhariu: 4820 dhe Muslimi: 1408

<sup>3</sup> Xhuma:9

<sup>4</sup> En-Nur:2

<sup>5</sup> Nisa:25

<sup>6</sup> Buhari: 25, Muslimi: 22

<sup>7</sup> Et-Teube: 29

<sup>8</sup> Buhari: 1412

Kurse specifikimi bëhet në një hadith tjetër: “Nuk jepet zeqat për atë sasi e cila është nën 5 Eusuk.”<sup>1</sup> pra nëse kemi ndër këtë sasi nuk jepet zeqati.

g. *Specifikimi i Sunnetit me Analogji.*

Shembull: “Nëse bëjnë amoralitet beqari apo beqarja, goditen 100 herë dhe largohen nga vendi i tyre për një vit.”<sup>2</sup>

E dimë se robëresha e ka dënimin për gjysmë nga gruaja e lirë, dhe nga kjo bëjmë analogjinë e robit beqar me robëreshën beqare dhe themi se për ta vlejnë vetëm nga 50 goditje.

---

<sup>1</sup> Buhari: 1340 , Muslim: 979

<sup>2</sup> Muslimi: 1690

[Shprehja e pa definuar (المُجْمَلُ) dhe shprehja e definuar (المُبَيَّنُ)]

*Shprehja e pa definuar (المُجْمَلُ) është ajo që ka nevojë për sqarim.*

*Sqarimi (الْبَيَانُ) është të nxjerrësh diçka nga gjendja e paqartësisë në gjendje të qartësisë.*

---

Nëse flasim për atë se sa kuptime i përmban një shprehje, mund të themi se ajo është dy lloje:

- a. *En Nass-Teksti i prerë:* Është ajo shprehje e cila nuk mund të përmbajë në vete më shumë se një kuptim.
- b. Shprehja e cila në vete përmban më shumë kuptime dhe nga ta është El Muxhmel.

**Përkufizimi gjuhësor:** përmbledhje.

**Përkufizimi terminologjik:** Është ajo shprehje e cila ka nevojë për shpjegim

**Arsyet që e bëjnë një shprehje të jetë e pa definuar (Muxhmel):**

**1. Mosnjohja e qëllimit.**

P.sh: “**Të shkurorëzuarat duhet të presin tre Kuru (cikle)**”.<sup>1</sup> Dijetarët kanë mospajtim në lidhje me kuptimin e fjalës “Kuru”.

**2. Mosnjohja e formës.**

Kemi një shprehje, por nuk na është treguar forma.

Si p.sh: “*dhe faleni namazin*”.<sup>2</sup>

**3. Mosnjohja e sasisë.**

Ajeti: “*...dhe jepeni Zekatin*”<sup>3</sup>

**4. Shprehje e cila për herë të parë ka ardhur Sheriati me atë kuptim,**

-Ka thënë Pejgamberi ﷺ: “*A e dini se kush është i falimentuar?*” Ata thanë: *I falimentuar tek ne është ai që nuk ka para dhe nuk posedon asgjë. Ai tha: “I falimentuari i vërtetë nga umeti im do të vijë ditën e kiametit me namaz, agjërime dhe zekat. Vjen, por e ka fyer këtë, ka shpifur për këtë, e ka ngrënë pasurin e këtij, e ka derdhë gjakun e këtij, e ka rrahur tjetrin. Atëherë ju jepet atyre nga të mirat e tij, e nëse përfundojnë të mirat e tij para sa t’i shpagojë këto padrejtësi, merren*

---

<sup>1</sup> El-Bekare: 228

<sup>2</sup> El-Bekare: 43

<sup>3</sup> El-Bekare: 43

*nga mëkatet e atyre që ju është bërë padrejtësi dhe i hedhen atij, e më pas hidhet në zjarr.”<sup>1</sup>*

---

<sup>1</sup> Muslimi

*Teksti i prerë (النَّصُّ) është ajo (shprehje) që mund të ketë vetëm një kuptim.  
Dhe thuhet: është diçka kuptimi i së cilës është shpallja.  
Fjala (النَّصُّ) en-nassu në përkufizimin gjuhësor rrjedh prej fjalës (مِنْصَّةُ الْعُرُوسِ),  
d.t.th. vendi i saj.*

---

**Përkufizimi gjuhësor:** Termi En Nass rrjedh nga fjala *minassatul arus*, që d.m.th podium. Pra, diçka të jetë e shfaqur dhe tepër e qartë.

**Përkufizimi terminologjik:** Shprehje e cila përmban vetëm një kuptim ose është diçka që është e qartë dhe në të cilën nuk ka dyshim.

---

<sup>1</sup> Vendi ku qëndron nusja gjatë dasmës, me qëllim që ta shohin të gjithë, skena

## [Shprehja e qartë (الظَّاهِرُ) dhe shprehja e interpretuar (المُؤَوَّلُ)]

*Shprehja e qartë (الظَّاهِرُ) është ajo që përmban dy kuptime, prej së cilëve njëri është më i qartë se tjetri.*

*Shprehja e qartë (الظَّاهِرُ) interpretohet me argument dhe quhet e qartësuar me argument.*

---

**Përkufizimi gjuhësor:** i dukshëm, evident.

**Përkufizimi terminologjik:** Është ajo e cila përmban dy kuptime, prej të cilëve njëri është më i qartë se tjetri apo se njëri ka përparësi ndaj tjetrit..

Dijetarët po ashtu kanë përmendur shkaqe që e bëjnë që e bëjnë një tekst të qartë:

### 1. El Hakikah (kuptimi i fjalëpërfjalshëm) përballë ElMexhaz (kuptimi figurativ)

P.sh. thënia: “E kam parë një luan”. Të gjithë ata që e dëgjojnë do të mendojnë se e ka parë kafshën e egër, kurse me fjalën luan e ka pasur për qëllim njeriun trim.

Në këtë rast nuk lejohet përdorimi i tillë i fjalëve kur e ke për qëllim kuptimin figurativ përveçse me indikator sqarues, si p.sh. “E pashë një luan në betejë”.

### 2. Të kuptuarit parimisht se shprehja është e plotë

D.m.th. kur dikush flet ne kuptojmë që ai ka plotësuar fjalimin e tij dhe ka shprehur atë që ka synuar. Pra, fjalimi është i plotë dhe nuk ka diç të fshehtë në të.

Si p.sh: “*Erdhi Zoti yt dhe engjëjt të radhitur në radhë.*”<sup>1</sup>

### 3. Shprehja të jetë absolute e jo e veçuar.

Ajeti: “*...lirim i një skllavi*”<sup>2</sup> në fillim e kuptojmë se është lirim i çfarëdo lloj skllavi, qoftë mysliman apo jo. Por nëse vjen argument tjetër se skllavi duhet të jetë mysliman atëherë ne e kuptojmë pikërisht kështu.

### 4. Shprehja e përgjithshme.

E kjo sepse shprehjet e përgjithshme janë të qarta, me mundësi për t’u specifikuar. Por nuk lejohet specifikimi i tyre përpos se me argument.

---

<sup>1</sup> El-Fexhr: 22

<sup>2</sup> El-Maide: 89

P.sh: I dërguari ﷺ: "Kur u pyet se a të marrim abdes pas ngrënies së mishit të devesë, i Dërguari ﷺ tha: "Po".<sup>1</sup>

### El Muevvel

**Përkufizimi gjuhësor:** Rrjedh nga arabishtja El Eulu që d.m.th. kthim. Pra, të kthesh diçka në diç tjetër.

**Përkufizimi terminologjik:** Është bartja e shprehjes në kuptimin jo parësor.

### -Te'vili tek dijetarët e Usulit lejohet vetëm nëse i plotëson tre kushte:

1) *Që shprehja të jetë e përshtatshme për interpretim*, pra që kuptimi jo parësor i shprehjes të ketë shumë gjasa të jetë i synuar me këtë shprehje.

Por nëse ky kuptim jo parësor është shumë i largët në këtë shprehje, themi se nuk merret parasysh.

Nëse fjala nuk e përmban kuptimin jo parësorë atëherë ky quhet Tevil fasid apo keqinterpretim

Siç është interpretimi i gabuar i fjalës së Allahut: "**Rahmani u ngrit mbi Arsh**"<sup>2</sup>

2) *Të ketë argument të qartë i cili do ta ndryshonte kuptimin parësor në kuptim tjetër jo parësor.*

P.sh: "**Besojeni Allahun dhe të dërguarin e tij dhe dritën të cilën e zbritëm...**"<sup>3</sup>

3) *Faktori i cili e bën interpretimin e domosdoshëm.*

Që të ketë diçka e cila e bën interpretimin të obligueshëm, si p.sh. kur teksti e kundërshton një parim të domosdoshëm të njohur shariatik, apo e kundërshton një tekst më të fortë.

P.sh. Hadithi: *Fqiu është më meritorë për fqinjësinë dhe hadithi: Nëse vendosen kufijtë dhe caktohen rrugët, nuk ka çiftim.*

<sup>1</sup> IbnHibani

<sup>2</sup> Taha:5

<sup>3</sup> Tegabun:8



### [Veprimet (الأفعال)]

*Një veprim profetik: Ose është në aspekt të adhurimit dhe bindjes, ose në aspekt tjetër.*

*Nëse argumenti tregon që është specifik për të, atëherë konsiderohet i tillë; përndryshe, nuk është i veçantë për të, sepse Allahu thotë: ( لَقَدْ كَانَ لَكُمْ فِي رَسُولِ اللَّهِ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ ) "Me të vërtetë ju e kishit shembullin më të mirë në të Dërguarin e Allahut."<sup>1</sup>. Tek disa prej dijetarëve tanë, kjo konsiderohet si detyrim dhe ka prej tyre që thonë konsiderohet si rekomandim (e pëlqyeshme), dhe prej tyre disa thanë: Përmbahemi nga qëndrimi.*

*Nëse vepra nuk ka të bëjë me adhurim apo bindje, atëherë kuptohet si lejim për të ﷺ, ashtu edhe për ne.*

---

Prej argumenteve të dispozitave janë edhe veprimet e Pejgamberit ﷺ.

Thotë autori: *një veprim profetik ose është në aspektin e adhurimit dhe bindjes ose në aspekte tjera. Pra, ose është adhurim ose nuk është i tillë.*

Vepra si vepër fillimisht nuk konsiderohet si specifike për Pejgamberin ﷺ, për këtë shkak autori thotë: *“nëse argumenti tregon për diç të tillë”*.

**Thotë autori:** *Nëse vepra nuk ka të bëjë me adhurim apo bindje atëherë kuptohet si lejim për të dërguarin ﷺ, ashtu edhe për ne.*

Veprat në këtë kontekst ndahen në dy lloje:

1. Vepra që kanë të bëjnë me njeriun si personalitet, pra kemi të bëjmë me Pejgamberin ﷺ si individ. Këtu hyn ecja e tij, fjetja, ushqimi, pija, qeshja, veshja, parfumimi, etj.
2. Vepra që kanë të bëjnë me zakonet dhe traditat. Kjo sepse Pejgamberi ﷺ ka jetuar në shoqëri e cila i ka pasur zakonet dhe traditat e tyre të veshjes, ecjes etj.

Sunneti i dërguarit ﷺ është tri llojesh: fjalët, veprimet dhe aprovimet e tij ﷺ.

---

<sup>1</sup> El-Ahzab 21

## [Aprovimi (الإقرار)]

*Aprovimi i Pejgamberit për një thënie të dikujt është sikur ta ketë thënë ai, dhe aprovimi i tij për veprën e dikujt është sikur ta ketë vepruar ai vetë. Nëse është vepruar diçka jashtë prezencës së tij dhe ai e ka ditur dhe nuk e ka ndaluar atë, atëherë është sikur veprimi të jetë bërë në praninë e tij.*

---

**Aprovim** d.m.th diçka me të cilën është pajtuar ai ﷺ, qofshin fjalë, veprime që janë bërë në prezencën e tij ﷺ dhe ai ﷺ ka heshtur dhe nuk e ka kundërshtuar apo mohuar atë fjalë apo veprim.

Aprovimi mund të jetë si për thënie ashtu dhe për vepra.

**Shembull për vepër:** Loja e fëmijëve të Habeshes: “Një ditë e pashë të dërguarin ﷺ tek dera e dhomës sime ndërsa Abisinianët luanin në xhami”<sup>1</sup>. Ata luanin me shtiza dhe pejgamberi ﷺ nuk i ka kundërshtuar kurse Aisheja r.a e ka shikuar lojën e tyre.

**Shembull për thënie:** Fjala e Ebu Bekrit r.u: çdo luftëtar mysliman i cili në luftë e vret një luftëtar jomysliman, e gjithë pronësia e luftëtarit të vrarë qafir bëhet pronësi e vrasësit. Këtë propozim të Ebu Bekrit r.u e ka dëgjuar Pejgamberi ﷺ dhe ka heshtur, kështu që është bërë pjesë e fesë Islame.

Nëse është vepruar diçka jashtë prezencës së tij ﷺ dhe ai e ka ditur por nuk e ka ndaluar, atëherë kjo është e njëjtë sikur të jetë bërë në praninë e tij, me kusht që vepruesi të jetë mukelef.

---

<sup>1</sup> Buhariu: 443

## [Shfuqizimi (النسخ)]

*Ndërsa (النسخ) En-Neskhu në etimologji d.m.th. largim: thuhet (نَسَخْتُ الشَّمْسُ الظَّلَّ) largoi dielli hijen. Po ashtu thuhet se nënkupton transferim, për shkak të thënies, (نَسَخْتُ مَا فِي الْكِتَابِ), d.m.th. transferova çdo gjë që është në libër.*

*Përkufizohet si: adresim i veçantë dhe i ri që tregon për ngritjen e një dispozite fetare të vendosur nga një adresim i mëparshëm, në formë që nëse s' do kishte qenë ky [adresim i ri], do të mbetej [dispozita e vjetër] në fuqi.*

---

### **Përkufizimi gjuhësorë:**

1. Largim dhe ngritje. Shembull: “Largoi dielli hijen.”

2. Transferim. Shembull: “Transferova çdo gjë që është në libër”.

**Përkufizimi terminologjik:** Thotë komentuesi i librit Abdullah el Feuzan se EnNeskh është: *Ngritja e dispozitës së argumentit fetar apo leximit të tij me argument nga Kurani dhe Sunneti.*

Në kapitullin e shfuqizimit kemi:

1. En Neskhu si proces
2. En Nasikhu (shfuqizuesi)
3. El Mensukhu (teksti i shfuqizuar).

Dijetarët janë të mendimit se nëse vendimi ndaj një çështjeje zëvendësohet me një vendim tjetër, neskhu është i pranuar.

Shembull: “*O ju që keni besuar, kur dëshironi të bisedoni me të dërguarin, jepni një sadaka para bisedës suaj.*”<sup>1</sup>

Është shfuqizuar me:

*A u frikësuat (varfërisë) të jepni lëmoshë në prag të bisedës suaj? E kur ju nuk e bëtet dhe All-llahu ju fali, atëherë pra falni namazin, jepni zeqatin...”*<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup> El-Muxhadele:12

<sup>2</sup> Muxhadele:13

*Është e mundshme që shkrimi të shfuqizohet duke mbetur dispozita, ose dispozita të shfuqizohet dhe të mbetet shkrimi.*

*[Lejohet] zëvendësimi gjatë shfuqizimit, ose të mos ketë aspak zëvendësim; dhe [është e mundshme] që shfuqizimi të bëhet me diçka më të rreptë ose me diçka që është më e lehtë.*

---

Në bazë të tekstit të shfuqizuar, autori ka përmendur tri lloje të shfuqizimit:

**1. Shfuqizimi i shkrimit por të mbetet dispozita.**

P.sh. Ajeti i gurëzimit i cili është larguar nga Kurani, ndërsa dispozita ka ngelur.

**2. Shfuqizimi i dispozitës dhe mbetja e leximit.**

P.sh: *“Nëse prej jush janë njëzet të durueshëm, (trima të fuqishëm), do t'i mundni dyqind, e nëse janë njëqind, do t'i mundni një mijë sish që nuk besuan”<sup>1</sup>*

Më vonë kjo dispozitë është shfuqizuar me ajetin: *“All-llahu ju bëri lehtësim tash duke e ditur se jeni dobësuar. Nëse prej jush janë njëqind të durueshëm, do ti mundni dyqind, e nëse prej jush janë një mijë, me ndihmën e Zotit do t'i mundni dy mijë.”<sup>2</sup>*

**3. Shfuqizimi i tekstit edhe dispozitës.**

Thotë Aisha: *“Ajo e cila ishte zbritur prej Kuranit ishte dhjetë mëndje të njohura që pastaj e njëjta të llogaritet si nënë prej qumështi, pastaj kjo u shfuqizua në pesë të tilla”<sup>3</sup>*

Shfuqizimi mund të bëhet me një dispozitë më të rreptë apo me një më të lehtë.

Thotë Allahu i Madhëruar: *“Ne nuk shfuqizojmë asnjë nga argumentet tona, apo ta hedhim në harresë e të mos sjellim edhe më të dobishëm se ai, ose të ngjashëm me te...”<sup>4</sup>*

Thotë autori: *shfuqizimi lejohet të bëhet me diçka më të rreptë.*

Ja edhe një ndarje siç do paraqitet në vijim:

**1. Shfuqizimi me dispozitë më të rreptë**

---

<sup>1</sup> El-Enfal: 65

<sup>2</sup> El-Enfal: 66

<sup>3</sup> Muslimi: 1452

<sup>4</sup> El-Bekare: 106

Shembull: Në fillim është agjëruar vetëm dita e Ashurasë, pastaj u zëvendësua me agjërimin e muajit të Ramazanit për atë që dëshiron, e kush nuk agjëron bën shpagim. ***“E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të obliguar për shpagim, ushqim (ditor) i një të varfëri.”***<sup>1</sup>

E pastaj është shfuqizuar zgjedhja dhe ka mbetur vetëm obligueshmëria e agjërimin. ***“E kush e përjeton prej jush këtë muaj le të agjërojë”.***<sup>2</sup>

## 2. Shfuqizimi me dispozitë më të lehtë

Këtë e kemi përmendur tek ajeti: ***“...e nëse janë njëqind, do t’i mundni njëmijë sish që nuk besuan...”***<sup>3</sup>, pastaj Allahu e ka shfuqizuar këtë me ajetin: ***“Nëse prej jush janë njëqind të durueshëm, do ti mundni dyqind...”***<sup>4</sup>.

## 3. Shfuqizim me dispozitë të nivelit të njëjtë

Shembulli i ndryshimit të drejtimit të kibles.

---

<sup>1</sup>El-Bekare:184

<sup>2</sup>El-Bekare:185

<sup>3</sup>Enfal: 65

<sup>4</sup>Enfal: 66

*Lejohet shfuqizimi i Kuranit me Kuran, shfuqizimi i sunetit me Kuran dhe sunet.*

---

## **Ndarja e shfuqizimit në bazë të tekstit shfuqizues:**

*Lejohet:*

### **1. Shfuqizimi i Kuranit me Kuran:**

#### **2. Shfuqizimi i Sunetit me Kuran:**

Këtu shfuqizuesi është Kurani ndërsa i shfuqizuar Suneti.

Shembull për këtë është hadithi i Ibn Abasit në ndalesën e ngrënies, pirjes dhe marrëdhënieve intime pas jacisë ose siç ka ardhur në transmetime tjera, pas gjumit.

Kjo dispozitë e vërtetuar me thënien e Pejgamberit ﷺ, dhe pastaj është shfuqizuar me fjalën e Allahut: ***“Ju lejohet që në netët e Ramazanit të keni kontakt me gratë tuaja ngase ju jeni petku i tyre dhe ata janë petku juaj”***.<sup>1</sup>

Ky ajet ua ka lejuar myslimanëve që të hanë e pinë dhe të kenë kontakt me bashkëshortet.

#### **3. Shfuqizimi i Sunetit me Sunnet:**

Thotë Pejgamberi ﷺ ***“Ju pata ndaluar nga vizita e varreve, ndërsa tash vizitoni ato, për shkak se vizita e tyre ua përkujton botën tjetër”***.<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup> El-Bekare: 187

<sup>2</sup> Tirmidhiu: 1954

*Lejohet shfuqizimi i mutevatirit me mutevatir, shfuqizimi i ahad-it me ahad dhe mutevatir, por nuk mundet shfuqizimi i Kuranit me sunet dhe mutevatir-it me ahad, sepse shfuqizimi bëhet me diçka të njëjtë ose më të fortë.*

---

Mutevatiri është dy llojesh: Kurani dhe një pjesë e Sunnetit të Pejgamberit ﷺ.

**Përkufizimi terminologjik:** ElMutevatiru është transmetimi i një grupi që nuk mundet të komplotojnë gënjeshtër derisa të përfundon transmetimi tek burimi.

Kurani është transmetuar me tevatir si dhe një pjesë e Sunnetit të Pejgamberit ﷺ .

Lejohet:

### **1. Shfuqizimi i Kuranit me Sunnet mutevatir:**

Ajeti: *“U është obliguar juve që kur ti vijë dikujt vdekja të shkruajnë testament dhe që këtë ta bëjë për prindërit dhe të afërmit e tij”*.<sup>1</sup>

-Ky Ajet është shfuqizuar me thënien e Pejgamberit ﷺ: *“Allahu ia ka dhënë çdonjërit të drejtën e tij, andaj nuk ka testament për trashëguesin”*.<sup>2</sup>

Pra, nuk ka nevojë të shkruajmë testament për atë që trashëgon, sepse për të ka sasi të caktuar prej pasurisë dhe ka konsensus për pranueshmërinë e kuptimit të këtij hadithi.

### **2. Shfuqizimi i Sunnetit mutevatir me Sunnet mutevatir.**

Për këtë dijetarët janë të gjithë të pajtimit, por është shumë e vështirë të gjendet shembull për diç të tillë. Kjo gati se nuk ekziston.

Autori thotë: *Lejohet shfuqizimi i ahad-it me ahad dhe mutevatir,*

**Përkufizimi terminologjik:** Ahad është çdo lloj hadithi i cili nuk e ka arritur shkallën e mutevatirit.

Lejohet shfuqizimi e Ahadit me Ahad, dhe lejohet shfuqizimi i Ahadit me Mutevatir i cili është shumë më i fort se Ahadi. Por problemi është se nuk mund të gjejmë shembull të shfuqizimit të Ahadit me Mutevatir.

Kurse të shfuqizimi i Ahadit me Ahad i kemi hadithet që i kemi përmendur të shfuqizimi i Sunnetit me Sunnet.

Nuk lejohet shfuqizimi i Kuranit me Sunnet Ahad është mendimi i shumicës së dijetarëve, ndërsa shfuqizimin e sunnetit Mutevatir me sunet Ahad po. Dhe shembull për këtë e kemi ndryshimin e Kibles.

---

<sup>1</sup> El- Bekare: 180

<sup>2</sup> EbuDavudi: 2532

## [Kontradikta mes argumenteve]

*Kur dy argumente kundërshtohen, atëherë ose të dy janë të përgjithshëm, ose të dy janë specifik, ose njëri është i përgjithshëm dhe tjetri është specifik, ose secili prej tyre është i përgjithshëm nga një këndvështrim dhe specifik nga këndvështrimi tjetër.*

*Nëse të dytë janë të përgjithshëm dhe harmonizimi është i mundshëm, atëherë bëhet harmonizim, e nëse s'është harmonizimi i mundshëm dhe nuk dihet periudha e zbritjes, atëherë përmbahemi nga vendimi. Dhe nëse dihet periudha e zbritjes, atëherë i mëvonshmi e shfuqizon të mëparshmin.*

---

Dijetarët kanë thënë se realisht nuk ekziston ndonjë lloj kontradikte mes argumenteve të Kuranit dhe Sunnetit, por kontradikta vjen në bazë të mangësisë së njohurive të Muxhtehidit dhe në bazë të paaftësisë së tij që të hulumtojë dhe studiojë argumentet më të cilat do ta përforcojë njërin argument me tjetrin.

Autori ka përmendur katër raste kur mund që të duket se një tekst e kundërshton një tekst tjetër.

### **1. Kundërshtimi të jetë mes dy argumenteve që janë të përgjithshëm.**

Në raste të tilla dijetarët kanë pasur një metodologji e cila në veti përmban disa hapa:

- a. *Harmonizimi mes argumenteve*, që prej dy argumenteve që në shikim të parë duket se e kundërshtojnë njëri-tjetrin të nxirret një konkluzion i përbashkët.
- b. *Shfuqizimi*, nëse njëri nga argumentet është shfuqizuar nga tjetri.
- c. *Favorizimi*: kanë thënë dijetarët se është fuqizimi i njërit argument ndaj argumentit tjetër të kundërt.

Favorizimi është: favorizimi i njëres palë të argumenteve ndaj palës tjetër me argument.

Shembull: Hadithi i Busrasë e cila thotë se ka thënë Pejgamberi ﷺ: “*Ai i cili e prek organin e tij gjenital le të marrë abdes.*”<sup>1</sup> Nga kjo nënkuptojmë se prekja e organit intim i prish abdesin.

Argument tjetër i cili e kundërshton këtë argument është hadithi i cili transmetohet nga Talk bin Ali radijAllahu anhu i cili ka thënë: *Një burrë tha: Preka organin tim gjenital. Ose ka thënë: Personi prek organin e tij gjenital në namaz, a ka detyrë të marr abdes? Profeti ﷺ tha: “Ai është pjesë e jotja.”*<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup> Tirmidhiu: 82

<sup>2</sup> EbuDavud: 182



*E njëjta vlen kur të dytë janë specifik.*

---

Nëse të dy argumentet janë specifike, si ka mundësi t'i shtjellojmë e t'i studiojmë. Pra, edhe këtu ndiqet metoda e njëjtë.

**1. Harmonizimi**

Shembull për këtë e kemi Hadithin e Xhabir bin Abdilah i cili thotë se Pejgamberi ﷺ gjatë Haxhxhit ditën e Kurban Bajramit e fali drekën në Mekke<sup>1</sup>, ndërsa në Hadithin e Ibn Omerit ka ardhur se Pejgamberi ﷺ e fali drekën në Mina.<sup>2</sup>

**2. Shfuqizimi**

Thotë Allahu: *“O Pejgamber, Na të kemi lejuar ty që gratë tuaja të jenë ato të cilave u ke dhënë dhuratat e kurorëzimit”*<sup>3</sup> D.m.th. Allahu na tregon në këtë Ajet se ia ka lejuar Pejgamberit ﷺ çdo grua të cilës ia jep mehrin.

Ajeti i lartpërmendur është shfuqizuar me ajetin në vijim: *“Prej tash – nuk të lejohen gratë (që t'i marrësh për bashkëshorte), as të marrësh tjetër grua në vend të tyre, e sikur madje edhe të të magjeps bukuria e tyre, pos skllaveve.”*<sup>4</sup>

**3. Favorizimi:**

Bëhet vetëm nëse nuk e dimë datën e ardhjes së këtyre argumenteve, pra nuk e dimë se cili është më i hershëm dhe cili më i vonshëm.

Shembull: Hadithi i Mejmunes dhe Ibn Abasit, që janë dy Hadithe që flasin për martesën e Pejgamberit ﷺ me Mejmunen.

Në Hadithin e Mejmunes ajo thotë: *“Më martoi mua ai ﷺ në gjendje të hallallit”*.<sup>5</sup> Gjendja e hallallit është gjendja pasi që personi del prej Ihramit.

Ndërsa në Hadithin e Ibn Abasit ai thotë: *“E martoi Pejgamberi ﷺ Mejmunen në gjendjen e Ihramit”*.<sup>6</sup>

---

<sup>1</sup> Muslimi: 1218

<sup>2</sup> Muslimi: 1308

<sup>3</sup> El-Bekare: 50

<sup>4</sup> El-Bekare: 52

<sup>5</sup> EbuDavud: 1843

<sup>6</sup> Buhariu: 1837

*Nëse njëri është i përgjithshëm, e tjetri specifik, atëherë i përgjithshmi kuptohet sipas specifikut.*

*Nëse secili prej tyre është i përgjithshëm në një aspekt dhe specifik në aspekt tjetër, atëherë specifikohet e përgjithshmja e secilit prej tyre me specifikimin e tjetrit.*

---

Kjo është e lehtë sepse kur njëri argument është i përgjithshëm e tjetri specifik, punohet me argumentin specifik, d.m.th. bëhet specifikimi i argumentit të përgjithshëm.

Thotë Allahu i Madhëruar: **“vjedhësit dhe vjedhëses pritjani duart...”**<sup>1</sup>

Ndërsa i dërguari ﷺ thotë: **“Nuk pritet dora, veçse për vjedhjen e çerek dinarit e më tepër.”**<sup>2</sup>, pra për çka është nën çerek të dinarit të artë nuk pritet dora.

Thotë autori: *Nëse secili prej tyre është i përgjithshëm në një aspekt dhe specifik në aspekt tjetër,*

Atëherë themi se në këtë rast specifikohet pjesa e përgjithshme e argumentit tjetër me pjesën specifike të argumentit të parë.

Shembull: **“E ata që vdesin dhe lënë gra pas vete, ato (gratë) presin katër muaj e dhjetë ditë.”**<sup>3</sup>

Dhe ajeti tjetër: **“Kurse gratë shtatzëna Iletin (pritjen) e vet e kanë derisa t’i lindin fëmijët e tyre”**.<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup>El-Maide: 38

<sup>2</sup>Buhariu: 6789

<sup>3</sup>El-Bekare: 234

<sup>4</sup>Et-Talak: 4

## [Konsensusi/Konsensusi (الإجماع)]

*Konsensusi (الإجماع) është pajtimi i dijetarëve të një kohe për një dispozitë lidhur me një dukuri.*

*Me "dijetarët" kemi për qëllim fukahatë, dhe me "dukuri" kemi për qëllim një dukuri shariatike.*

*Konsensusi i këtij Ummeti është argument, por jo edhe i ummeteve tjera, për shkak të thënies së tij ﷺ: "Ummeti im nuk do të pajtohen në humbje." Dhe ka ardhur në Sheriat se ky Ummet është i mbrojtur (nga Konsensusi në dalalet).*

---

Njëri nga argumentet e dispozitave pas Kuranit dhe Sunnetit është konsensusi.

**Përkufizimi gjuhësor:** Konsensus do të thotë pajtim rreth diçkaje ose vendosmëri.

**Përkufizimi terminologjik::** Pajtimi i dijetarëve të një kohe pas Pejgamberit ﷺ për një dispozitë lidhur me një dukuri.

**Argumentet më të cilat ne e vërtetojmë se konsensusi është argument i dispozitave në fenë e Allahut.**

1. Thotë Allahu i Madhëruar: *“Dhe ai i cili e kundërshton Pejgamberin e Allahut pasi që i është bërë e qartë e vërteta , dhe pason rrugë tjetër përveç rrugës së besimtarëve ne e lëmë në atë të cilën ai e ka zgjedhur dhe e fusim në zjarr dhe sa përfundim i keq është ai”*.<sup>1</sup>

2. *”Dhe kështu ne ju bëme juve popull të drejtë.”*<sup>2</sup>

3. Thotë Pejgamberi ﷺ: *“Nuk pajtohet (bashkohet) ummeti im në humbje, dhe dora e Allahut është me Xhematin.”*<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup> En-Nisa: 115

<sup>2</sup> El-Bekare: 143

<sup>3</sup> Tirmidhiu: 2167

*Konsensusi është argument për gjeneratat e ardhshme, pa marrë parasysh kur është bërë ai.*

*Nuk është kusht vdekja e asaj gjenerate, sipas mendimit më të vërtetë. Nëse themi: Vdekja e gjeneratës është kusht, atëherë duhet të merret në konsideratë edhe opinioni i dikujt që ka lindur gjatë jetës së tyre, ka studiuar dhe është bërë muxhtehid.*

*Po ashtu ata (muxhtehidët) kanë të drejtë të ndryshojnë atë vendim.*

*Konsensusi bëhet i vlefshëm me fjalët ose me veprimet e tyre, ose me thëniet e disa prej tyre dhe veprimet e disa tjerëve, kur kjo do të ishte përhapur dhe të tjerët do të heshtnin.*

Duhet ditur se konsensusi nuk është i një kategorie, andaj edhe dijetarët fillimisht e kanë ndarë atë në dy lloje :

1. *Konsensus i prerë*: çdokush nga umeti ka njohuri mbi ekzistencën e këtij konsensusi.

P.sh. konsensusi se alkooli, zinaja, etj, janë haram.

2. *Konsensus i mundshëm*: kuptohet përmes vëzhgimit dhe hulumtimit dhe ka mospajtim në ekzistencën e tij. Ka mundësi që në gjeneratat e ardhshme të ketë dikush i cili e kundërshton këtë konsensus.

P.sh: Thënia e Abdullah ibn Shekik: “Sahabët e peygamberit ﷺ nuk mendonin se lënia e ndonjë veprimi përbënte mosbesim, përveç lënies së namazit”<sup>1</sup>

Thotë autori: *Konsensusi bëhet i vlefshëm me fjalët ose me veprimet e tyre...*

Pra, konsensusi është rezultat i pajtimit të fjalëve apo veprimeve.

Pastaj vazhdon autori dhe thotë: *kur kjo do të ishte e përhapur dhe të tjerët do të heshtnin*, d.m.th. kur ekziston konsensus dhe një grup i muxhtehidëve heshtin ndaj tij dhe nuk e kundërshtojnë, llogaritet si i pranuar. Përndryshe i njëjti quhet konsensus me heshtje.

<sup>1</sup> Tirmidhiu: 2622

## [Qëndrimi (mendimi) i sahabiut]

*Qëndrimi i një individi prej sahabëve nuk është argument për të tjerët, sipas qëndrimit<sup>1</sup> të ri, ndërsa sipas të vjetrit është argument.*

---

Qëndrimi i sahabiut, është një çështje për të cilën ka polemika mes dijetarëve se a është argument i dispozitave apo jo.

**Përkufizimi terminologjik:** Gjithçka e cila është transmetuar nga një prej sahabëve të Pejgamberit ﷺ qoftë fjalë, vepër apo aprovim i tij në një çështje fetare.

Sahabi është ai person i cili e ka takuar Pejgamberin ﷺ duke e besuar atë dhe ka vdekur si mysliman.

Dijetarët janë të pajtimit se qëndrimi i sahabiut në çështjet të cilat ka hapësirë për ixhtihad nuk është argument për një sahabi tjetër dhe se lejohet marrja e qëndrimit të sahabiut në çështjet në të cilat nuk ka hapësirë për ixhtihad.

A llogaritet mendimi i sahabiut argument apo jo?

Dijetarët rreth kësaj çështjeje janë ndarë në dy mendime, ndërsa Shejh Abdullah el Feuzan (komentuesi i el varakat) ka thënë se qëndrimi i sahabiut lejohet të merret si argument për çështjet për të cilat nuk ka argument nga Kurani, Sunneti ose konsensusi i muslimanëve. Kjo është kështu sepse ka mundësi që sahabi ta ketë marrë këtë dituri prej Pejgamberit ﷺ.

E gjithë kjo, duke pasur parasysh se duhet të plotësohen dy kushte:

- a. Ky qëndrim, apo mendim i sahabiut të mos kundërshton tekstet e Kuranit dhe Sunetit
- b. Qëndrimi apo mendimi i sahabiut, të mos kundërshtohet nga ndonjë sahabi tjetër.

---

<sup>1</sup> Qëndrimi i Imam Shafiut

## [Transmetimet (الأخبار)]

*Transmetimi është diçka që mund të përmban vërtetësi ose e gënjeshtër.*

*Transmetimet ndahen në:*

1. *Ahad (أحَادٌ)*
2. *Mutevatir (مُتَوَاتِرٌ)*

**Mutevatir** është ai transmetim që ofron dituri, e ai është transmetimi i një grupi që nuk mund të komplotojnë gënjeshtër, prej një grupi të ngjashëm me ta, deri sa të përfundon transmetimi tek burimi, dhe në esencë duhet të jetë diçka që është parë ose dëgjuar, e jo konkluzion.

---

Fjala ElAkhbar është shumësi i fjalës Elkhaber (transmetim), dhe është diçka që mund të përmbaj vërtetësi ose gënjeshtër.

### **El-Mutevatir**

**Përkufizimi gjuhësor:** Fjala El-Mutevatiru rrjedh nga fjala tevatera, d.m.th. ardhja e e diçkaje njëra pas tjetrës, apo pasimi i diçkaje me diç tjetër.

**Përkufizimi terminologjik:** ElMutevatiru është transmetimi i një grupi që nuk mundet të komplotojnë gënjeshtër derisa të përfundon transmetimi tek burimi.

### **Kushtet e të qënurit një transmetim Mutevatir.**

1. Të transmetohet nga një numër i konsiderueshëm.
2. Në kushte normale të jetë e pamundur që ata të komplotojnë gënjeshtër.
3. Në të gjitha hallkat e këtij zinxhiri të transmetimit të plotësohen dy kushtet e lartpërmendura.
4. Referencë e asaj që e tregojnë të jetë shqisat e tyre, e të mos jetë konkluzion.

Njashtu, nga mutevatir përfitojmë edhe obligueshmërinë e të vepruarit me këtë dituri.

Mutevatiri ndahet në:

- a. Mutevatir tekstual
- b. Mutevatir kuptimor.

D.m.th. ka hadithe që janë mutevatir në formë të kuptimit siç janë hadithet për mestet, këto janë transmetuar me tekste të ndryshme nga sahabë të ndryshëm të Pejgamberit ﷺ. Por kemi edhe hadithe të cilat janë transmetuar me tekst të njëjtë nga Pejgamberi ﷺ siç është hadithi: “Kush gënjen për mua qëllimisht, le ta përgatit vendin e tij në

*zjarr*<sup>1</sup> Ky hadith është transmetuar në këtë formë tekstualisht nga i dërguari i Allahut ﷺ nga shumë prej sahabeve.

---

<sup>1</sup> Buhari: 1229

*Ahad është ai transmetim që obligon veprimin por nuk ofron dituri (të sigurt). Ndahet në dy lloje: Mursel (مُرْسَلٌ) dhe në Musned (مُسْنَدٌ)*

---

**Përkufizimi gjuhësor:** Fjala elahad është shumësi i fjalës ehad që d.m.th. një, i vetëm.

**Përkufizimi terminologjik:** Është ai transmetim i cili nuk e ka arritur shkallën e tevaturit.

Thotë autori: *Transmetimi Ahad është ai transmetim që obligon veprimin.*

Dhe kjo pa marrë parasysh a është transmetim i lidhur me besim apo i lidhur me veprime të dukshme.

Argument për këtë kemi ndërrimin e kibles nga Kudsi në drejtim të Mekes.

Pastaj autori thotë: *Ahadi nuk ofron dituri të sigurt, por ofron dituri të mundshme.* Prandaj për transmetimin Ahad ne nuk themi se është 100% i saktë, por themi se ai ofron një lloj diturie e cila është e mundshme, probabiliteti që të jetë ashtu është i madh.

Në bazë të lidhjes dhe shkëputjes së vargut të transmetuesve, Ahadi ndahet në:

1. Mursel
2. Musned



*Musned (مُسْنَدٌ) është transmetimi që e ka zinxhirin e lidhur.*

*Mursel (مُرْسَلٌ) është transmetimi që e ka zinxhirin e shkëputur. Nëse është prej merasil-ëve të tjerëve veç sahabëve, atëherë nuk është argument, përpos merasil-ëve të Se'id ibn el-Musejjib, që janë hulumtuar dhe janë gjetur të jenë të pashkëputura.*

---

**El Musned:** Tek dijetarët e usulit është transmetimi i cili e ka zinxhirin e lidhur.

**El Mursel:** Tek dijetarët e usulit është transmetimi i cili e ka zinxhirin e shkëputur.

*Thotë autori: Nëse është prej merasilëve – të tjerëve përveç sahabëve atëherë nuk është argument.*

Mursel i sabahiut është kur një sahabi thotë ka thënë Pejgamberi ﷺ për diçka të cilën nuk e ka parë dhe nuk e ka dëgjuar me veshët e tij. Ose e ka dëgjuar prej sahabëve tjerë ose e ka dëgjuar prej Pejgamberi ﷺ në ndonjë ndodhi tjetër në të cilën nuk ka qenë prezent, por e tregon sikur të kishte qenë në vendngjarje.

P.Sh. thënia e Aishes: “Fillimisht, të Dërguarit të Allahut ﷺ shpallja i vinte në formë të ëndrrave të mira në gjumë. Nuk ndodhte që të shihte ndonjë ëndërr e pastaj të mos i realizohej sikurse drita e agimit”<sup>1</sup>

*Pastaj autori thotë: përpos merasil-ëve të Se'id ibn elMusejjib, që janë hulumtuar dhe janë gjetur të jenë të pashkëputura.*

---

<sup>1</sup> Buhariu: 3, Muslimi: 160

### [Format e transmetimeve]

*Zinxhiri transmetues mund të përmbajë a'na'neh (عَنْتَهُ).*

*Kur shejhu lexon, i lejohet transmetuesit të thotë: Më ka treguar (حَدَّثَنِي) edhe më ka lajmëruar (أَخْبَرَنِي). Nëse transmetuesi i lexon mësuesit, atëherë duhet të thotë më ka lajmëruar (أَخْبَرَنِي), por jo më ka treguar (حَدَّثَنِي).*

*Më ka dhënë ixhaze (أَجَازَنِي) ose më ka treguar përmes ixhazes (أَخْبَرَنِي إِجَازَةً).*

---

An-a'neh d.m.th në zinxhirin e transmetimit nuk është problem nëse përmendet thënia “an” (d.m.th. nga, prej), sepse fjala “an “ shpesh përdoret si sinonimi i fjalës ka thënë, kam dëgjuar, më ka treguar.

Kusht është që thanësi (transmetuesi) i fjalës “an” të mos jetë mudelis. Mudelisi bën një formë maskimi të transmetimit.

Pastaj vazhdon autori duke treguar gradat e transmetimit, duke filluar nga më e larta:

1. Kur shejhu i lexon nxënësit (transmetuesit). I lejohet transmetuesit të thotë: më ka treguar ose më ka lajmëruar dhe kjo është forma më e lartë e transmetimit.
2. Nëse transmetuesi i lexon mësuesit. Ka nga dijetarët që këtë e kanë vërtetuar me fjalë, ndërsa imam Maliku e bënte me heshtje. Kur transmetuesi i lexon mësuesit atëherë ai duhet të thotë më ka lajmëruar e jo më ka treguar.
3. Nëse mësuesi i jep atij ixhaze (autorizim, licencë) për të transmetuar pa lexim. Duke mos lexuar aspak tek hojha ose duke mos u lexuar hojha nxënësve.

## [Analogjia (القِيَاسُ)]

*Analogjia është kthimi i degëzimit në bazën e saj në aspekt të vendimit, përmes një shkakut që i bashkon ato (në dispozitë).*

---

Është njëri prej argumenteve më të rëndësishme dhe njëri prej katër argumenteve të njohura tek dijetarët për nxjerrjen e dispozitave.

Argumentet për legjitimitetin e Analogjisë:

***“Ne i kemi dërguar profetët tanë me argumente të qarta dhe me ata kemi shpallur librin dhe peshojnë që njerëzit të sillen me drejtësi.”***<sup>1</sup>

Analogjia është përmendur në thëniet e sahabeve, tabiinëve po ashtu është përmendur në hadith të Pejgamberit ﷺ të cilin e transmeton Ebu Hurejre, se “Një njeri nga Beni Fezare erdhi tek Pejgamberi ﷺ dhe i tha: “O i Dërguar i Allahut, bashkëshortja ime lindi foshnje të zezë (me këto fjalë nënkuptojnë mohimi i atësisë). Tha Pejgamberi ﷺ: “A posedon deve? Tha: “Po”. Tha Pejgamberi, ﷺ: “Çfarë ngjyre kanë ato?” Tha: “Të kuqe.” Tha Pejgamberi, ﷺ: “A ke ngjyrë dheu (kafeje)”. “Po, ka kësi soj ngjyre tha ai. Pejgamberi ﷺ e pyeti: “E si mund të ndodhë kjo?” Tha: “Ky përngjasim mund të jetë nga origjina (paraardhësit). Tha Pejgamberi ﷺ: “ndoshta ky përngjasim i birit tënd mund të jetë nga origjina”<sup>2</sup>

**Përkufizimi gjuhësor:** Fjala ElKijas në gjuhën arabe d.m.th *barazim, vlerësim.*

**Përkufizimi terminologjik:** Analogjia është kthimi i degëzimit në bazën e saj në aspekt të vendimit, përmes një shkakut që i bashkon ato (në dispozitë).

Në definicion kemi:

- a) Degëzimin: (është ajo për të cilën dëshirohet vendosja e dispozitës)
- b) Bazën: (ajo për të cilën ka dispozitë)
- c) Vendimi: (Dispozita që synohet nga krahasimi i degës me bazën)
- d) Shkakut: (elementi i përbashkët i degëzimit dhe bazës, ajo që i bashkon ato në dispozitë)

Dhe mu këto janë katër shtyllat e analogjisë.

---

<sup>1</sup> Hadid: 25

<sup>2</sup> Muslimi: 2848

*Ndahet në tre lloje: Analogji shkakore (فَيَاسُ عِلَّةٍ), Analogji indikative (فَيَاسُ دَلَالَةٍ) dhe Analogji përngjasuese (فَيَاسُ شَبَهٍ).*

*Analogji shkakore (فَيَاسُ عِلَّةٍ) është kur shkakun domosdoshmërisht rezulton me dispozitë.*

*Analogjia indikative (فَيَاسُ دَلَالَةٍ) është argumentimi i një prej dy gjërave të ngjashme për tjetrën dhe që shkakun (الْعِلَّةُ) të aludon për dispozitën, e jo domosdoshmërisht të rezulton me të.*

*Analogjia përngjasuese (فَيَاسُ شَبَهٍ) është kur një degë frekuenton mes dy bazave (rrënjave), andaj i jepet dispozita e rrënjës të cilës i ngjan më së shumti.*

*Një prej kushteve të degës (الْفَرْعُ) është që të jetë në përputhshmëri me bazën (الأَصْلُ). Ndërsa prej kushteve të bazës është që të jetë e vendosur me argument për të cilin pajtohen të dy palët kundërshtuese.*

*Një prej kushteve të shkakut (الْعِلَّةُ) është të jetë njëjtë i pranishëm në diturinë e dhënë, ashtu që mos ta kundërshtojë fjala kuptimin (qëllimin).*

*Një prej kushteve të dispozitës (الْحُكْمُ) është që të jetë si shkakun në mungesë dhe prani. Shkakun është ai që shkakton nxjerrjen e dispozitës, ndërsa dispozita është rezultat i shkakut.*

*Analogji shkakore – “Mos ju thuaj atyre as Uf...”<sup>1</sup> Logjikisht kuptojmë ne se ky ajet ndalon edhe nga rrahja, sharja, si dhe goditja e prindërve.*

*Analogjia indikative – P.sh: Alkooli është haram, sepse ai që e pi atë humb mendjen dhe bën vepra të pakontrolluara. Këtu bëjmë analogji me drogën. Andaj themi se shkak i ndalesës është dehja, e jo lëngu apo pluhuri*

*Analogjia përngjasuese – Tek EbuHanifja, flokët në abdes fërkohen një herë, dhe atë duke e krahasuar me fërkimin mbi meste, dhe me tejemumin.*

<sup>1</sup> Isra: 23

## [Ndalesa dhe lejueshmëria (الْحَظْرُ وَالْإِبَاحَةُ)]

*Disa thonë: Të gjitha çështjet janë të ndaluara derisa sheriati t'i lejoj ato, andaj, nëse nuk ka asgjë në shariat që tregon për lejueshmërinë e asaj gjëje, ne duhet t'i kthehemi esencës, që është ndalimi.*

*Dhe prej tyre ka që thonë të kundërtën, domethënë që esenca për gjërat është lejueshmëria, përpos për ato që sheriati i ka ndaluar.*

---

El Hadhru – *diçka e ndaluar,*

El Ibahatu – *diçka e lejuar.*

Kjo çështje flet për dispozitën e gjërave para ardhjes së tekstit fetar, për të cilën autori thotë se: *të gjitha çështjet janë të ndaluara derisa Sheriati t'i lejojë.*

Ky është mendimi i parë dhe këta dijetarë mendojnë se gjithçka që ekziston, fillimisht dispozita e saj ka qenë ndalesa (Haram), derisa të vijë argument shariatik që dëshmon lejueshmërinë e së njëjtës.

Mendimi dytë i dijetarëve është e kundërta e saj, pra çdo gjë e dobishme në tokë lejohet, andaj për këtë qëndrim të tyre janë argumentuar me një numër argumentesh si nga Kurani ashtu edhe nga Suneti.

Ajeti: **“Allahu krijoi për ju gjithçka çka ka në tokë”**.<sup>1</sup>

I dërguari ﷺ ka thënë: *“Më të vërtetë myslimani më i padrejtë ndaj myslimanëve është ai i cili pyet për diçka e cila nuk është e ndaluar, dhe pastaj ndalohet për shkak të tij.”*<sup>2</sup>

Çështjet në fenë e Allahut janë dy lloje:

1. Çështje për dispozitat e të cilave ka argument fetar.
2. Çështje për të cilat nuk ka argument. Për këtë çështje ka disa mendime, por shumica e dijetarëve janë të mendimit se esenca e gjërave është lejueshmëria.

---

<sup>1</sup> El-Bekare: 29

<sup>2</sup> Buhariu: 7289

### **El-Istis'hab (الإستصحاب)**

*Istis'hab domethënë që dispozita bazike të vazhdoj në mungesë të argumentit sheriatik.*

---

Autori përmend Istis-habin sepse është një prej argumenteve të dispozitave për të cilin ka mospajtim mes dijetarëve.

**Përkufizimi gjuhësor: Istis'hab** në gjuhën Arabe d.m.th. kërkesë për shoqërim, sepse “ اس “ Elifi dhe Sin në fillim të çdo fjalisë tregojnë se kjo folje ka të bëjë me kërkesë për diçka.

**Përkufizimi terminologjik:** El-Istis'hab domethënë që dispozita bazike të vazhdojë në mungesë të argumentit Sheriatik.

Si shprehje e përafërt juridike do njëhej si prezumimi i vazhdimësisë së gjendjes.

Thotë Ibn Tejmije: “Me të vërtetë Istis-habi në shumicën e rasteve është prej argumenteve më të dobëta”.

**[Renditja e provave (argumenteve) (تَرْتِيبُ الْأَدِلَّةِ)]**

*Sa për argumentet, u jepet përparësi argumenteve të qarta para atyre të paqarta, argumenteve që ofrojnë dije të prerë, para atyre që ofrojnë dije të mundshme, shprehjet mbi analogjitë, dhe analogjisë së qartë mbi analogjinë e paqartë. Nëse një shprehje përfshin diçka që ndryshon gjendjen bazike (atëherë zbatohet); përndryshe kemi prezumim të vazhdimësisë së gjendjes.*

---

**Në aspekt të qartësisë,** *iu jepet përparësi argumenteve të qarta para atyre të paqarta. Këtu me qartësi është për qëllim kuptimi i qëllimit të argumentit. Për këtë arsye themi se tekstit të prerë i jepet përparësi ndaj tekstit të qartë, ndërsa tekstit të qartë i jepet përparësi ndaj tekstit të interpretuar dhe kështu me radhë duke i krahasuar argumentet në aspekt të qartësisë.*

**Në aspekt të diturisë që e ofrojnë,** *iu jepet përparësi argumenteve që ofrojnë dije të prerë, para atyre që ofrojnë dije të mundshme. Andaj themi që i jepet përparësi argumentit që ofron Jekin (bindje) ndaj atij që ofron Dhann (supozim).*

**Në aspekt të burimit,** *iu jepet përparësi shprehjeve sheriatike mbi analogjitë dhe analogjisë së qartë mbi atë të paqartë.*

### [**Cilësitë e muftiut dhe musteftiut** (صِفَةُ الْمُفْتِيِّ وَالْمُسْتَفْتِيِّ)]

*Prej kushteve të muftiut është që ta njeh Fikhun në bazë dhe degët e tij, mospajtimet e dijetarëve dhe medhhebin, t'i ketë të gjitha mjetet e nevojshme për ixhtihad, që të di çka i nevojitet për të nxjerrë dispozitat, si gramatikën, gjuhën arabe, njohjen e transmetuesve, tefsirin e ajeteve Kuranore dhe haditheve që kanë të bëjnë me dispozitat.*

---

Këtu do të përmendim cilësitë që duhet ti posedojë ai person i cili merret me nxjerrjen e dispozitave fetare.

Mufti është personi i cili jep fetua, ndërsa dijetarët kanë thënë se muftiu është lajmëtar i një dispozite fetare.

#### **Prej kushteve të muftiut është:**

1. *Njohja e Fikhut si në bazë ashtu edhe në degët e tij.*

Është për qëllim çështjet më të rëndësishme të Fikhut të cilat llogariten si baza të cilat më vonë degëzohen në shumë çështje tjera.

- a. *T'i dijë mospajtimet e dijetarëve dhe medhhebeve, t'i dijë divergjencat e dijetarëve në një çështje, sepse nëse nuk i di divergjencat e dijetarëve ka mundësi të dalë me një thënie që nuk e ka thënë askush më parë.*
- b. *Duhet ta dijë medhhebin. Kur e përmendim fjalën mufti autori ka për qëllim muxhtehidin, i cili mund të jetë muxhtehid në medhheb apo muxhtehid jashtë medhhebit.*

2. *Ti posedojë të gjitha mjetet e nevojshme për ixhtihad.*

Siç është mendja e shëndoshë, niveli i lartë i perceptimit, etj.

3. *Të ketë njohuri mbi gjërat që do ti nevojiten për nxjerrjen e dispozitave, sikurse:*

- a. *Gramatikën e Gjuhës Arabe (Sintaksën dhe Morfologjinë), sepse njohja e saj është edhe njohje e fjalëve të Allahut dhe të dërguarit të Tij.*
- b. *Njohjen e transmetuesve.*
- c. *Njohjen e Tefsirit të Kuranit. Së paku njohjen e tefsirit të ajeteve që kanë të bëjnë me ajetet e dispozitave.*
- d. *Njohjen e Tefsirit të Haditheve – Është për qëllim hadithet që kanë të bëjnë me dispozitat.*



*Prej kushteve të musteftiut është që ai të jetë prej atyre që pasojnë, meqë do ta pason muftiun në fetuanë e tij. Nuk është e lejuar për një dijetar të pasoj askënd tjetër. Taklidi (التقليد) domethënë të pranosh qëndrimin e dikujt pa argument. Sipas këtij përkufizimi, pranimi i thënies së Pejgamberit (ﷺ) quhet taklid. Prej tyre ka që thonë se taklidi është të pranosh qëndrimin e dikujt pa e ditur në çka është i bazuar qëndrimi i tij. Nëse themi që Pejgamberi (ﷺ) gjykonte me analogji, lejohet të thuhet se pranimi i këtij qëndrimi është taklid.*

---

Musteftiu është kërkuesi i një dispozite fetare. Është personi i cili kërkon një dispozitë fetare nga muftiu.

Prej kushteve të musteftiut është që ai të jetë prej atyre që pasojnë, që bëjnë taklid.

### **Taklidi:**

**Përkufizimi gjuhësor:** hallkë që vendoset rreth qafës, qafore.

**Përkufizimi terminologjik:** Pasimi i atij personi, mendimi i të cilit nuk është argument (pasimi i Ebu Hanifes, Shafiut, Malikut etj), ose është të pranosh qëndrimin e dikujt pa e ditur se në çka është i bazuar qëndrimi i tij.

Pasimi i Pejgamberit ﷺ a është Taklid ?

Jo nuk është, sepse buron nga një njeri fjalët e të cilit janë argument.

## [Ixhtihadi (الإجتِهَادُ)]

*Ixhtihad është bërja gjithçka që është e mundur për arritjen e qëllimit. Nëse një muxhtehid është i pajisur në mënyrë adekuate me mjetet e ixhtihadit, atëherë nëse ixhtihadi i tij në çështjet e sheriatit e shpien në konkluzion të saktë, shpërblehet dyfish, e nëse ixhtihadi i tij e shpien në konkluzion të gabuar, atëherë ai ka një shpërblim.*

*Disa kanë thënë që çdokush që bën ixhtihad në çështjet e degëve (të sheriatit) ia ka qëlluar, por nuk lejohet të thuhet që çdo njeri që bën ixhtihad në çështjet e besimit ia ka qëlluar, sepse kjo do të çonte në konkluzion që të krishterët, mexhusët, jobesimtarët dhe heretikët të gjithë ia kanë qëlluar.*

*Argumenti i atyre që thonë se çdo muxhtehid nuk ia ka qëlluar në çështjet e degëve (të sheriatit) është thënia e të dërguarit (ﷺ): "Kushdo që bën ixhtihad dhe ia qëllon shpërblehet dyfish, dhe kushdo që bën ixhtihad dhe gabon shpërblehet njëfish".<sup>1</sup>*

*Mënyra e argumentimit është se Pejgamberi (ﷺ) e cilësoi si gabim muxhtehidin në njërin rast dhe se ia ka qëlluar në rastin tjetër.*

**Përkufizimi gjuhësor:** Ixhtihadi është dhënia e maksimumit dhe bërja gjithçka që është e mundur për arritjen e një çështje të vështirë.

**Përkufizimi terminologjik:** Ixhtihadi është bërja gjithçka që është e mundur deri në arritje të dispozitës, ose bërja gjithçka që është e mundur nga ana e fekihut deri në arritjen e qëllimit të tij.

Nëse një muxhtehid është i pajisur në mënyrë adekuate me mjetet e ixhtihadit, dhe ixhtihadi i tij në çështjet e Sheriatit shpie në konkluzion të saktë, shpërblehet dyfish, e nëse shpie në konkluzion të gabuar, ka vetëm një shpërblim.

Thotë autori: *Mënyra e argumentimit është se Pejgamberi (ﷺ) e cilësoi si gabim muxhtehidin në njërin rast dhe se ia ka qëlluar në rastin tjetër, ndërsa shpërblimi i muxhtehidit lidhet me mundin e tij dhe me dhënien e maksimumit që të arrijë deri tek qëllimi.*

<sup>1</sup> Buhariu: 6919